

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PRISHTINË

OE ANKUES: MEB L.L.C., Rr. "Edit Durham" nr. 213, 20000 Prizren, Republika e Kosovës

AK SPITALIT "SHEIKH ZAYED" – VUSHTRRI Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK (Departamenti I Prokurimit)

Data: 18.08.2026



Ankese

Kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Spitali i Përgjithshëm "Sheikh Zayed" në Vushtrri, të datës 10.08.2026, me të cilin është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e MEB L.L.C. dhe është lënë në fuqi rekomandimi për dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik SCORPION GROUP SH.P.K.

AKTIVITETI I PROKURIMIT

Autoriteti Kontraktues: **Spitali i Përgjithshëm "Sheikh Zayed" – Vushtrri**

Titulli: "Sigurimi fizik i objektit të Spitalit të Përgjithshëm Vushtrri"

Numri i prokurimit: 220/70050-26-5318-2-2-1

Operatori Ekonomik Ankues: **MEB L.L.C.**

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë: **SCORPION GROUP SH.P.K.**

Vendimi i kundërshtuar: Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 10.08.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe lënien në fuqi të rekomandimit për dhënie të kontratës. **Në mbështetje të neneve 4.1.26, 7, 10, 11, 24, 52, 53, 56, 59, 60, 61, 72, 105, 108/A, 109, 111** dhe dispozitave të tjera relevante të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024, Operatori Ekonomik Ankues MEB L.L.C., brenda afatit ligjor, parashtrohet këtë:

ANKESË NË ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT

kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 10.08.2026, për shkak të:

- konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- mosadministrimit dhe mosvlerësimit objektiv të provave;
- moslejimit të qasjes efektive në dokumentacionin vendimtar;
- zbatimit të gabuar të dispozitave materiale dhe procedurale të LPP-së;
- zbatimit jokonsistent dhe selektiv të kërkesave të Dosjes së Tenderit;
- trajtimit të pabarabartë të operatorëve ekonomikë;
- mungesës së transparencës në ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve;
- pranimit si të përgjegjshme të një oferte për të cilën nuk është mundësuar verifikimi i përmbushjes së kërkesave materiale;
- moszbatimit të procedurës ligjore për verifikimin e realizueshmërisë së çmimit të ofertuar; dhe
- nxjerrjes së një vendimi të paarsyetuar, kontradiktor dhe të pambështetur në prova konkrete e të verifikueshme.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqëndrueshëm, sepse Autoriteti Kontraktues i ka refuzuar pretendimet e MEB L.L.C. me arsyetimin se Ankuesi nuk ka paraqitur prova për mangësitë e ofertës së rekomanduar, ndërkohë që vetë Autoriteti Kontraktues ka refuzuar t'i japë Ankuesit qasje në analizën financiare, raportin e vlerësimit të riskut dhe dokumentacionin e menaxherëve. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta mbajë të fshehur dokumentacionin vendimtar dhe, njëkohësisht, ta refuzojë kërkesën e Ankuesit me arsyetimin se nuk janë paraqitur prova lidhur me përmbajtjen e dokumenteve në të cilat qasja është ndaluar. Një arsyetim i tillë është në kundërshtim me parimet e transparencës, barazisë së armëve, trajtimit të barabartë dhe mjetit juridik efektiv, si dhe me **nenet 7, 10, 11 dhe 108/A të LPP-së**.

I. HYRJE

MEB L.L.C., në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, ofertues dhe palë e interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 26 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, duke qenë drejtpërdrejt e cenuar nga rezultati i aktivitetit të prokurimit, brenda afatit ligjor dhe pas zhvillimit të procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas nenit 108/A të LPP-së, në mbështetje të neneve 105, 109 dhe 111 të LPP-së, paraqet këtë:

A N K E S Ë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Spitali i Përgjithshëm “Sheikh Zayed” – Vushtri, të datës 10.08.2026, me të cilin:

është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e MEB L.L.C., e datës 08.08.2026;

është lënë në fuqi rekomandimi për dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik SCORPION GROUP SH.P.K.; dhe

është lejuar vazhdimi i aktivitetit të prokurimit me numër 220/70050-26-5318-2-2-1. Kjo ankesë paraqitet në pajtim

me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqëndrueshëm, faktikisht i paplotë dhe proceduralisht i kundërligjshëm, sepse është nxjerrë:

mbi bazën e një gjendjeje faktike të konstatuar në mënyrë të mangët;

pa administrim dhe vlerësim të plotë të provave;

pa trajtim individual dhe substancial të pretendimeve të ngritura nga Ankuesi;

pa arsyetim konkret dhe matematikisht të verifikueshëm lidhur me analizën financiare të ofertës së rekomanduar;

pa mundësuar qasje efektive në dokumentet mbi të cilat Autoriteti Kontraktues pretendon se e ka mbështetur vendimin;

duke ia bartur në mënyrë të padrejtë Ankuesit barrën për të provuar përmbajtjen dhe mangësitë e dokumenteve që vetë Autoriteti Kontraktues i ka mbajtur të fshehura;

duke zbatuar standard të ndryshëm dhe më tolerant ndaj Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë; dhe

duke mos e zbatuar standardin rigoroz të vlerësimit që i njëjti Autoritet Kontraktues e ka zbatuar dhe mbrojtur në procedurën e mëparshme për të njëjtin lloj aktiviteti të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim kryesisht me formulimin se MEB L.L.C. “nuk ka paraqitur prova konkrete”. Ky arsyetim është në vetvete kontradiktor, sepse Autoriteti Kontraktues nuk i ka lejuar Ankuesit qasje në:

analizën financiare të SCORPION GROUP SH.P.K.;

Raportin e Vlerësimit të Riskut;

kontratat e punës së menaxherëve; dhe

dokumentet e tjera të klasifikuara në mënyrë të përgjithshme si konfidenciale.

Autoriteti Kontraktues nuk mund ta përjashtojë dokumentacionin vendimtar nga qasja dhe pastaj ta refuzojë mjetin juridik me arsyetimin se Ankuesi nuk ka dëshmuar se çfarë përmbajnë ose çfarë nuk përmbajnë dokumentet e fshehura. Një qasje e tillë e shndërron të drejtën për rishqyrtim në një të drejtë vetëm formale, sepse i kërkon Ankuesit të provojë mangësi në dokumente që nuk i janë vënë në dispozicion. Kjo cenon drejtpërdrejt parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, kontradiktoritetit procedural dhe mjetit juridik efektiv, të garantuara me nenet 7, 10, 11 dhe 108/A të LPP-së. Vendimi i kundërshtuar nuk e ka trajtuar në mënyrë substanciale faktin se SCORPION GROUP SH.P.K. ka ofertuar çmim identik prej 4.93 € për orë me TVSH për dy pozicione me

strukturë thelbësisht të ndryshme financiare:

shërbimin 24/7, i cili përfshin punë gjatë natës, vikendeve dhe festave zyrtare; dhe

shërbimin tetëorësh, i cili realizohet nga e hëna deri të premten, në orarin 07:00–15:00.

Në vend që të paraqiste kalkulime konkrete që dëshmojnë se çmimi i pozicionit 24/7 i mbulon të gjitha shtesat e kërkuara, Autoriteti Kontraktues është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se analiza financiare është shqyrtuar dhe se përmban 22,656 orë për periudhën 24-mujore. Përputhja e numrit të përgjithshëm të orëve nuk dëshmon përlogaritjen e drejtë të pagave, kontributeve, shtesave për natë, vikende, festa, orëve shtesë, pushimeve, uniformave, pagës së menaxherit, fitimit dhe TVSH-së. Prandaj, konstatimi i Autoritetit Kontraktues nuk i përgjigjet pretendimit të ngritur dhe nuk e vërteton realizueshmërinë e ofertës. Po ashtu, në lidhje me certifikatat për siguri dhe shëndet në punë, Autoriteti Kontraktues është përqendruar vetëm në përmbajtjen tematike të tyre dhe në termin “Ergonomia”, ndërsa nuk e ka trajtuar pretendimin thelbësor të Ankuesit se të pesë certifikatat mbajnë datën 21.11.2022 dhe se nuk është paraqitur dëshmi për vazhdimin, ripërtëritjen apo vlefshmërinë e tyre në datën e dorëzimit të tenderit, më 23.07.2026 e cila certifikatat për siguri dhe shëndet dhe pune janë valide nga data e lishimit 24 mujore. Vendimi i kundërshtuar është gjithashtu në kundërshtim me standardin e zbatuar në lëndën e OSHP-së nr. 2024/0570, e cila lidhet me të njëjtin lloj aktiviteti, të njëjtin Autoritet Kontraktues dhe operatorin SCORPION. Në atë procedurë, ndaj MEB L.L.C. është zbatuar standard rigoroz për dokumentacionin teknik dhe analizën financiare, ndërsa në procedurën aktuale të njëjtat kërkesa janë zbatuar në mënyrë më tolerante ndaj operatorit të rekomanduar. Një ndryshim i tillë i standardit, pa bazë objektive dhe pa arsyetim të individualizuar, përbën trajtim të pabarabartë dhe zbatim selektiv të kriterëve, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Ankuesi i qëndron në tërësi pretendimeve, fakteve, provave dhe kërkesave të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 08.08.2026. Kërkesa për Rishqyrtim, së bashku me provat e bashkëngjitura, konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj ankese dhe i propozohet OSHP-së që ta administrojë dhe vlerësojë në tërësi.

Nëpërmjet kësaj ankese, MEB L.L.C. nuk kufizohet vetëm në përsëritjen e pretendimeve të mëparshme, por kundërshton drejtpërdrejt edhe ligjshmërinë, bazueshmërinë, arsyetimin dhe konstatimet e Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 10.08.2026.

Për rrjedhojë, Ankuesi kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

t'i shqyrtojë në mënyrë të plotë të gjitha pretendimet ankimore;

ta administrojë dokumentacionin e plotë të ofertës së SCORPION GROUP SH.P.K., përfshirë dokumentet e klasifikuara si konfidenciale;

ta verifikojë zë për zë analizën financiare të operatorit të rekomanduar;

ta vlerësojë ligjshmërinë e klasifikimit të dokumenteve si sekrete afariste;

ta krahasojë standardin e vlerësimit me atë të zbatuar në lëndën nr. 2024/0570;

të konstatojë shkeljet materiale dhe procedurale të Autoritetit Kontraktues; dhe

ta aprovojë ankesën e MEB L.L.C. si të bazuar.

II. SHKELJET LIGJORE

Ankuesi, duke analizuar në mënyrë të hollësishme veprimet dhe vendimin e Autoritetit Kontraktues, konsideron se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit janë cenuar parimet themelore të ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Në veçanti, mënyra e ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe arsyetimi i dhënë në vendimin e kundërshtuar, nuk janë në përputhje me kërkesat e detyrueshme të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Për këtë arsye, Ankuesi vlerëson se veprimet e Autoritetit Kontraktues përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore relevante dhe cenojnë integritetin e procesit të prokurimit.

Në këtë kontekst, Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur, ndër të tjera, dispozitat ligjore të LPP-së:

A. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

Neni 7 – Barazia në Trajtim dhe Mosdiskriminimi;

Neni 10, paragrafët 1–5 – Mjetet për Promovimin e Transparencës;

Neni 11, paragrafët 3–5 – Informatat Sekrete Afariste;

Neni 24 – Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktues;

Neni 27 – Dosja e Tenderit;

Neni 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes;

Neni 52 – Kriteret për Dhënien e Kontratës;

Neni 53 – Interpretimi i Kërkesave të Dosjes së Tenderit;

Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;

Neni 59, paragrafët 2 dhe 4 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve;

Neni 60, paragrafi 1.1 – Kriteret për Dhënien e Kontratës;

Neni 61, paragrafët 1–4 – Tenderët Jonormalisht të Ulët;

Neni 72 – Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë;

Neni 105 – Kompetencat e Organit Shqyrtues të Prokurimit;

Neni 108/A – Zgjidhja Paraprake e Mosmarrëveshjeve;

Neni 109 – Afatet për Parashtrimin e Ankesës;

Neni 111 – Përmbajtja dhe Forma e Ankesës.

B. Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 17.23–17.25 – Kushtet për Ekzekutimin e Kontratës dhe Mbrojtjen e Punëtorëve;

Neni 38 – Sqarimi dhe Plotësimi i Tenderëve;

Neni 40 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Neni 40.16 – Trajtimi i Pozicioneve të Ofruara me Çmim Zero ose Falas;

Neni 41 – Tenderët Jonormalisht të Ulët;

Neni 43 – Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues;

Neni 44 – Letrat Standarde për Tenderuesit.

C. Rregullorja Nr. 002/2024

Rregullorja Nr. 002/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

D. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 39 – E drejta në Pushim Vjetor të Paguar;

Neni 56 – Kompensimi Shtesë për Punën Jashtë Orarit, Punën gjatë Natës, Festave dhe Vikendeve;

Neni 59 – Pushimi Mjekësor me Pagesë.

E. Dokumentacioni detyrues i aktivitetit të prokurimit

Njoftimi për Kontratë;

Dosja e Tenderit;

Fleta e të Dhënave të Tenderit;

Aneksi 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme;

Sqarimet zyrtare të Autoritetit Kontraktues;

Kriteri i përcaktuar në pikën 30.1 të FDT-së – “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”.

A R S Y E T I M

Në kuadër të aktivitetit të prokurimit publik me titull “Sigurimi fizik i objektit të Spitalit të Përgjithshëm Vushtrri”, me numër të prokurimit 220/70050-26-5318-2-2-1, Autoriteti Kontraktues – Spitali i Përgjithshëm “Sheikh Zayed” – Vushtrri, ka zhvilluar procedurë të hapur të prokurimit, në të cilën kanë marrë pjesë gjashtë operatorë ekonomikë, përfshirë MEB L.L.C. Pas ekzaminimit dhe vlerësimit fillestar të ofertave, Autoriteti Kontraktues, më datë 05.08.2026, ka publikuar Formularin B58 – Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik SCORPION GROUP SH.P.K., me vlerë të përgjithshme të ofertës prej 111,694.08 €. MEB L.L.C., duke qenë pjesëmarrëse në procedurë dhe e cenuar drejtpërdrejt nga rezultati i saj, ka kërkuar qasje në dokumentacionin e operatorit të rekomanduar, me qëllim të verifikimit të ligjshmërisë së procesit të vlerësimit dhe përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit. Qasja në dokumentacion është mundësuar më datë 07.08.2026, por Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë të qasshëm dokumentacionin vendimtar mbi të cilin pretendon se e ka mbështetur konstatimin për përgjegjshmërinë e ofertës së SCORPION GROUP SH.P.K.

Në veçanti, MEB L.L.C. nuk është lejuar të ketë qasje në:

analizën financiare të operatorit të rekomanduar;

Raportin e Vlerësimit të Riskut;

kontratat e punës së menaxherëve; dhe

dokumentet e tjera të klasifikuara nga Autoriteti Kontraktues si konfidenciale (Raporti vlerësimit të tenderave)

Pavarësisht klasifikimit të këtyre dokumenteve si konfidenciale, Autoriteti Kontraktues nuk ka përgatitur dhe nuk i ka ofruar Ankuesit:

version të pastruar të dokumenteve, sipas nenit 11.4 të LPP-së, përmbledhje të përgjithshme josekrete, sipas nenit 11.5 të LPP-së; ose arsyetim të individualizuar që dëshmon plotësimin e kushteve kumulative për klasifikimin e secilit dokument si sekret afarist sipas nenit 11.3 të LPP-së. Pas qasjes së kufizuar dhe në bazë të dokumenteve që i janë vënë në dispozicion, MEB L.L.C., më datë 08.08.2026, ka paraqitur brenda afatit ligjor Kërkesën për Rishqyrtim, në pajtim me nenin 108/A të LPP-së.

Në Kërkesën për Rishqyrtim janë ngritur pretendime konkrete, të argumentuara dhe të mbështetura në dokumentacionin e disponueshëm, lidhur me:

mungesën e dëshmisë për vlefshmërinë e certifikatave për siguri dhe shëndet në punë;
moslejimin e qasjes në analizën financiare;
mosevidentimin e qartë të analizës financiare në dokumentacionin e ofruar gjatë qasjes;
strukturën dhe realizueshmërinë e çmimit të ofertuar;
çmimin identik prej 4.93 € për orë për shërbimin 24/7 dhe shërbimin tetëorësh;
përlllogaritjen e pagave, kontributeve dhe shtesave ligjore;
përlllogaritjen e pushimeve, uniformave, pagës së menaxherit, fitimit dhe TVSH-së;
përbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale;
Raportin e Vlerësimit të Riskut;
dokumentacionin e menaxherëve;
trajtimin e dokumenteve si konfidenciale;
moszbatimin e procedurës për verifikimin e realizueshmërisë së çmimit;
trajtimin e pabarabartë të operatorëve ekonomikë; dhe
standardin e zbatuar më parë në lëndën e OSHP-së nr. 2024/0570.

Autoriteti Kontraktues, me Vendimin e datës 10.08.2026, e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si të pabazuar dhe e ka lënë në fuqi rekomandimin për dhënie të kontratës SCORPION GROUP SH.P.K. Vendimi i kundërshtuar mbështetet kryesisht në konstatimin e përsëritur se MEB L.L.C. nuk ka paraqitur “prova konkrete” për pretendimet e ngritura dhe se Komisioni i Vlerësimit e ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorit të rekomanduar. Ky arsyetim është kundërthënës, i pamjaftueshëm dhe juridikisht i paqëndrueshëm. Autoriteti Kontraktues, nga njëra anë, e ka privuar MEB L.L.C. nga qasja në dokumentet kryesore të ofertës së rekomanduar, ndërsa, nga ana tjetër, e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim pikërisht me arsyetimin se Ankuesi nuk ka paraqitur prova lidhur me përbajtjen dhe mangësitë e atyre dokumenteve.

Autoriteti Kontraktues nuk mund:

ta mbajë të fshehur analizën financiare;

ta mbajë të fshehur Raportin e Vlerësimit të Riskut;

t’i mbajë të fshehura kontratat e menaxherëve;

të mos ofrojë version të pastruar ose përmbledhje josekrete më pas t’i kërkojë Ankuesit të provojë se çfarë mungon

në dokumentet që nuk i janë bërë të qasshme. Një standard i tillë e bën të pamundur ushtrimin efektiv të mjetit juridik dhe e zhvendos në mënyrë të padrejtë barrën e provës te pala së cilës i është mohuar qasja në burimin e provës.

Kjo qasje është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenet 7, 10, 11 dhe 108/A të LPP-së dhe me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, kontradiktoritetit procedural dhe kontrollit efektiv të ligjshmërisë. Vendimi i kundërshtuar nuk përmban një analizë të thelluar, individuale dhe të verifikueshme të secilit pretendim të ngritur nga MEB L.L.C. Autoriteti Kontraktues është mjaftuar me formulime të përgjithshme se dokumentacioni është “shqyrtuar”, se analiza financiare “i përmban elementet” dhe se operatori i rekomanduar “i plotëson kërkesat”.

Këto konstatime nuk shoqërohen me:

identifikimin e dokumenteve konkrete të verifikuara, citimin e pjesëve relevante të analizës financiare, paraqitjen e vlerave të përlllogaritura për secilin element, kontrollin matematikor të strukturës së çmimit, krahasimin e çmimit për pozicionin 24/7 me pozicionin tetëorësh, analizën e kostove për natë, vikende, festa dhe orë shtesë, verifikimin e vlefshmërisë së certifikatave, verifikimin e ligjshmërisë së konfidencialitetit ose arsyetimin se përse nuk është zbatuar procedura e nenit 61 të LPP-së.

Konstatimi i Autoritetit Kontraktues se analiza financiare e SCORPION GROUP SH.P.K. përmban gjithsej 22,656 orë për 24 muaj, përkatësisht 944 orë në muaj, nuk i përgjigjet pretendimit të Ankuesit.

Numri i përgjithshëm i orëve nuk dëshmon se për këto orë janë përlllogaritur saktë:

paga bazë prej 525.00 € bruto;

kontributi i punëdhënësit prej 5%;

shtesat për punën gjatë natës;

shtesat për punën gjatë vikendeve;

shtesat për festat zyrtare;

kompensimi për orët shtesë;

zëvendësimi gjatë pushimeve vjetore;

uniformat;

Per secilin shtese 5% kontributi e cila ka qene kusht obligativ

paga e menaxherit;

shpenzimet operative;

fitimi; dhe TVSH-ja.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues nuk i është përgjigjur pretendimit kryesor se SCORPION GROUP SH.P.K. ka ofertuar çmim identik prej 4.93 € për orë me TVSH për dy pozicione me strukturë thelbësisht të ndryshme të kostove. Shërbimi 24/7 përfshin punën gjatë natës, vikendeve dhe festave zyrtare, ndërsa shërbimi tetëorësh realizohet nga e hëna deri të premten, në orarin e rregullt 07:00–15:00. Vendimi nuk përmban asnjë shpjegim financiar se si këto dy pozicione, me ngarkesa ligjore të ndryshme, kanë rezultuar me çmim plotësisht të njëjtë për orë. Në lidhje me certifikatat për siguri dhe shëndet në punë, Autoriteti Kontraktues e ka reduktuar pretendimin e Ankuesit vetëm te përmbajtja tematike e certifikatave dhe te fjala “Ergonomia”. Pretendimi i MEB L.L.C. nuk ka qenë se përdorimi i termit “Ergonomia” e bën automatikisht certifikatën të papranueshme. Pretendimi thelbësor ka qenë se të pesë certifikatat mbajnë datën 21.11.2022 dhe se nuk është paraqitur dëshmi për vazhdimin, ripërtëritjen ose vlefshmërinë e tyre në datën 23.07.2026. Vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk e ka trajtuar këtë çështje materiale dhe nuk ka paraqitur asnjë verifikim nga institucioni lëshues apo organi kompetent lidhur me vlefshmërinë e certifikatave. Për më tepër, vendimi nuk e ka trajtuar në mënyrë të arsyetuar standardin e zbatuar në lëndën e OSHP-së nr. 2024/0570, që lidhet me të njëjtin lloj aktiviteti, të njëjtin Autoritet Kontraktues dhe operatorin SCORPION. Në atë procedurë, ndaj MEB L.L.C. është zbatuar standard rigoroz për analizën financiare dhe dokumentacionin teknik. Në procedurën aktuale, i njëjti standard nuk është dëshmuar se është zbatuar ndaj SCORPION GROUP SH.P.K. Ky devijim i paarsyetuar nga standardi i mëparshëm përbën trajtim të pabarabartë dhe aplikim selektiv të kërkesave, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Vendimi i kundërshtuar përmban gjithashtu pasaktësi formale në identifikimin e palës, pasi në fund të tij MEB L.L.C. është evidentuar gabimisht si “Msi SH.P.K. – Prishtinë”. Kjo pasaktësi, e kombinuar me mospërputhjet në procesverbalin e qasjes, ku përmendet GOE DEFENCE SECURITY SH.P.K. & BOLD SECURITY SH.P.K. në vend të SCORPION GROUP SH.P.K., krijon dyshim shtesë mbi saktësinë, kujdesin dhe individualizimin e shqyrtimit të rastit konkret.

Në këto rrethana, Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 10.08.2026:

nuk e ka konstatuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike

nuk i ka administruar provat në mënyrë objektive

nuk i ka trajtuar pretendimet sipas përmbajtjes së tyre reale

nuk ka dhënë arsyetim të individualizuar dhe të verifikueshëm

ka cenuar të drejtën për qasje dhe mjet juridik efektiv

ka zbatuar standard të pabarabartë vlerësimi dhe është nxjerrë në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, LPP-në dhe Rregulloren për Prokurimin Publik.

Për faktet, provat dhe shkeljet juridike të paraqitura më poshtë, Vendimi i kundërshtuar duhet të anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim të plotë, objektiv, transparent dhe të ligjshëm.

III. VENDIMI I KUNDËRSHTUAR NUK E PËRMBUSH STANDARDIN E ARSYETIMIT DHE TË VERIFIKIMIT OBJEKTIV

Autoriteti Kontraktues, në Vendimin e datës 10.08.2026, është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se

pretendimet e MEB L.L.C. “nuk janë mbështetur me prova konkrete” dhe se nuk ekziston bazë për ndryshimin e rekomandimit për dhënie të kontratës SCORPION GROUP SH.P.K.

Një formulim i tillë nuk përbën arsyetim të mjaftueshëm faktik dhe juridik dhe nuk e përmbush detyrimin e Autoritetit Kontraktues për shqyrtimin substancial, objektiv dhe të individualizuar të secilit pretendim të paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim.

Vendimi mbi Kërkesën për Rishqyrtim nuk mund të mbështetet vetëm në konstatime deklarative si:

“dokumenti është shqyrtuar”, “kërkesa është përmbushur”, “nuk është paraqitur provë konkrete” “nuk është konstatuar mangësi”; ose “pretendimi refuzohet si i pabazuar”.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të tregojë konkretisht:

cilin dokument e ka administruar, cilën kërkesë të Dosjes së Tenderit e ka krahasuar me atë dokument, cilën pjesë të dokumentit e ka konsideruar si provë të përmbushjes, cilat kalkulime i ka verifikuar, cilat vlera financiare ka konstatuar si ka arritur të përfundimi se dokumenti është i rregullt, si është konstatuar përgjegjshmëria e ofertës; dhe mbi cilën dispozitë ligjore është mbështetur refuzimi i secilit pretendim.

Në mungesë të këtyre elementeve, vendimi mbetet një pohim i pakontrollueshëm i Komisionit të Vlerësimit dhe jo një vendim i arsyetuar që mund t’i nënshtrohet kontrollit efektiv juridik nga Ankuesi dhe OSHP-ja.

Detyrimi i Autoritetit Kontraktues për verifikimin e ofertës

Sipas nenit 24 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues mban përgjegjësi për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në pajtim me ligjin.

Sipas nenit 56 të LPP-së, operatorët ekonomikë dhe tenderët duhet të vlerësohen sipas kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Për rrjedhojë, barra fillestare dhe kryesore për ekzaminimin, verifikimin dhe dokumentimin e përgjegjshmërisë së ofertës i takon Autoritetit Kontraktues dhe jo operatorit ekonomik ankues.

MEB L.L.C. nuk ka pasur detyrimin që ta kryejë në vend të Komisionit të Vlerësimit ekzaminimin e ofertës së SCORPION GROUP SH.P.K. Detyrimi i Ankuesit ka qenë që të identifikojë shkeljet, kundërthëniet dhe rrethanat që krijojnë dyshim të arsyeshëm mbi ligjshmërinë e vlerësimit.

Pas ngritjes së pretendimeve konkrete, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që:

t’i verifikojë ato kundrejt dokumentacionit origjinal;

t’i trajtojë sipas përmbajtjes së tyre reale;

të paraqesë rezultatin e verifikimit;

të japë arsyetim konkret për secilin pretendim; dhe të dëshmojë përputhshmërinë e ofertës me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta zëvendësojë këtë detyrim me formulimin se Ankuesi “nuk ka paraqitur prova konkrete”.

Zhvendosja e kundërligjshme e barrës së provës

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është veçanërisht kundërthënës, sepse dokumentet që përmbajnë provat kryesore kanë qenë në posedim ekskluziv të Autoritetit Kontraktues dhe nuk i janë bërë të qasshme MEB L.L.C.

Autoriteti Kontraktues nuk ka lejuar qasje në:

analizën financiare të SCORPION GROUP SH.P.K.;

Raportin e Vlerësimit të Riskut;

kontratat e punës së menaxherëve; dhe

dokumentet e tjera të klasifikuara si konfidenciale.

Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues i ka refuzuar pretendimet me arsyetimin se MEB L.L.C. nuk ka dëshmuar:

se në analizën financiare mungon ndonjë element;

se Raporti i Vlerësimit të Riskut nuk është i rregullt;

se menaxherët nuk i plotësojnë kërkesat; ose

se kontratat e punës nuk janë në përputhje me Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk mund ta pengojë Ankuesin që të ketë qasje në provë dhe pastaj ta përdorë mungesën e asaj prove si arsye për refuzimin e pretendimit.

Një arsyetim i tillë është rrethor dhe juridikisht i papranueshëm:

dokumenti nuk jepet në qasje sepse është shpallur konfidencial;

Ankuesi nuk mund ta verifikojë përmbajtjen e dokumentit pretendimi refuzohet sepse Ankuesi nuk ka paraqitur provë për mangësinë e dokumentit të fshehur.

Kjo mënyrë e vendimmarrjes cenon nenet 7, 10, 11 dhe 108/A të LPP-së dhe e bën të drejtën për mjet juridik joefektive.

Pretendimet kanë qenë konkrete dhe të verifikueshme

Pretendimet e MEB L.L.C. nuk kanë qenë deklarime të përgjithshme, supozime abstrakte ose pakënaqësi subjektive me rezultatin e tenderit.

Ato kanë pasur të bëjnë me elemente konkrete dhe të verifikueshme të ofertës së SCORPION GROUP SH.P.K., përkatësisht me:

certifikatat për siguri dhe shëndet në punë, të cilat mbajnë datën 21.11.2022 dhe për të cilat nuk është dëshmuar vazhdimi, ripërtëritja ose vlefshmëria më 23.07.2026;

analizën financiare, e cila nuk është bërë e qasshme dhe nuk është evidentuar qartë në listën e dokumenteve të ofruara gjatë qasjes;

strukturën e kostove, për të cilën nuk është paraqitur asnjë kalkulim konkret në vendimin e kundërshtuar;

numrin dhe strukturën e orëve, ku përputhja formale me 944 orë në muaj nuk dëshmon përlllogaritjen e drejtë të kostove për secilin lloj të orëve;

çmimin identik prej 4.93 € për orë për shërbimin 24/7 dhe shërbimin tetëorësh, pavarësisht ngarkesës së ndryshme financiare;

fitimin e kompanisë, jo në kuptim të kërkesës për një fitim minimal, por si element që duhej të ishte realisht i përfshirë dhe i identifikueshëm në analizën financiare;

Raportin e Vlerësimit të Riskut, i cili është mbajtur i fshehur dhe nuk ka mundur të verifikohet nga Ankuesi;

dokumentacionin e menaxherëve, për të cilin nuk është lejuar qasje e plotë kontratat e punës, të cilat janë klasifikuar në tërësi si konfidenciale dhe ligjshmërinë e klasifikimit të dokumenteve si konfidenciale, pa version të pastruar dhe pa përmbledhje josekrete. A

Secili prej këtyre pretendimeve ka qenë i përcaktuar dhe i verifikueshëm drejtpërdrejt nga dokumentacioni origjinal që ndodhet në posedim të Autoritetit Kontraktues.

Mungesa e analizës konkrete për certifikatat

Lidhur me certifikatat për siguri dhe shëndet në punë, Autoriteti Kontraktues është përqendruar te fakti se certifikatat përmbajnë tema si “Ergonomia”.

Mirëpo, pretendimi thelbësor nuk është trajtuar.

Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar:

cili është afati i vlefshmërisë së certifikatave;

nëse certifikatat e datës 21.11.2022 kanë qenë valide më 23.07.2026, nëse është bërë verifikim te institucioni lëshues, nëse është paraqitur dëshmi për trajnim rifreskues nëse është bërë ricertifikimi i punëtorëve; ose mbi cilën bazë faktike dhe juridike janë pranuar si të vlefshme.

Deklarimi se MEB L.L.C. nuk ka sjellë konfirmim nga institucioni lëshues nuk e liron Autoritetin Kontraktues nga detyrimi që vetë ta verifikojë vlefshmërinë e dokumenteve mbi të cilat ka mbështetur kualifikimin e operatorit të rekomanduar.

Mungesa e analizës konkrete financiare

Lidhur me analizën financiare, Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se ajo përmban:

pagën bazë; kontributet; shtesat për natë, vikende dhe festa; orët shtesë; pushimet; per secilin kosto +5% kontributi uniformat; menaxherin; fitimin; TVSH-në; dhe totalin e ofertës.

Megjithatë, vendimi nuk tregon:

vlerën e asnjërit prej këtyre elementeve; formulën e përdorur; numrin e orëve për secilën kategori; përqindjet e aplikuara; ndarjen ndërmjet pozicionit 24/7 dhe pozicionit tetëorësh; përputhjen matematikore me çmimin 4.93 € për orë; fitimin konkret të paraqiturose mënyrën se si është arritur totali prej 111,694.08 €. Deklarimi se analiza “i përmban elementet” nuk dëshmon se ato janë përlllogaritur saktë dhe me vlerë reale. Përfshirja formale e një titulli ose e një pozicioni në analizë nuk është e barabartë me përlllogaritjen ligjore dhe financiare të tij.

Numri i përgjithshëm i orëve nuk dëshmon strukturën e kostos

Autoriteti Kontraktues është mbështetur në konstatimin se analiza financiare përmban 22,656 orë për 24 muaj, përkatësisht 944 orë në muaj. Ky konstatim nuk i përgjigjet pretendimit të Ankuesit.

Numri i përgjithshëm i orëve dëshmon vetëm sasinë e shërbimit, por nuk dëshmon:

sa orë janë llogaritur si punë gjatë natës;

sa orë janë llogaritur si punë gjatë vikendeve;

sa orë janë llogaritur si punë gjatë festave;

sa orë janë trajtuar si orë shtesë;

cilat shtesa janë aplikuar në cilat përqindje janë aplikuar dhe nëse mbi secilën shtesë është llogaritur kontributi i punëdhënësit prej 5%. Prandaj, përdorimi i numrit të përgjithshëm të orëve si përgjigje ndaj pretendimit për strukturën e kostove përbën shmangie nga thelbi i pretendimit dhe jo shqyrtim të tij.

Mosarsyetime të çmimit identik për dy pozicione të ndryshme

Vendimi nuk jep asnjë përgjigje konkrete se si SCORPION GROUP SH.P.K. ka ofertuar çmim identik prej 4.93 € për orë për:

shërbimin 24/7, me punë gjatë natës, vikendeve dhe festave dhe shërbimin tetëorësh, nga e hëna deri të premten, në orarin 07:00–15:00. Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë kalkulim që dëshmon se çmimi i shërbimit 24/7 i mbulon kostot shtesë të detyrueshme. Mosadresimi i këtij pretendimi material e bën vendimin të paplotë dhe të paarsyetuar.

Mungesa e arsytimit për nenin 61 të LPP-së

Autoriteti Kontraktues është mjaftuar me deklarimin se çmimi më i ulët, në vetvete, nuk përbën dëshmi të përgjegjshmërisë së ofertës. MEB L.L.C. nuk ka pretenduar se oferta duhet të eliminohet automatikisht vetëm sepse është më e lirë. Pretendimi ka qenë se struktura e çmimit, çmimi identik për pozicionet e ndryshme, kostot fikse dhe diferenca financiare kërkonin verifikim të posaçëm të realizueshmërisë së ofertës.

Vendimi nuk tregon:

nëse është vlerësuar aplikueshmëria e nenit 61 të LPP-së;

nëse janë zbatuar kriteret e nenit 41 të Rregullores Nr. 001/2022;

nëse janë kërkuar sqarime për strukturën e çmimit çfarë sqarimesh janë pranuar dhe mbi cilat prova është konstatuar realizueshmëria e ofertës.

Vendimi nuk mund të mbështetet vetëm në autoritetin e Komisionit të Vlerësimit

Fakti se Komisioni i Vlerësimit ka deklaruar se oferta është e përgjegjshme nuk e bën këtë konstatim të pakontestueshëm. Qëllimi i procedurës së rishqyrtimit është pikërisht kontrolli i ligjshmërisë së konstatimeve të Komisionit të Vlerësimit. Nëse Autoriteti Kontraktues e refuzon kërkesën vetëm duke përsëritur përfundimin e Komisionit, pa administruar dhe paraqitur arsye konkrete mbi të cilat ai përfundim është mbështetur, procedura e rishqyrtimit humb kuptimin dhe efektivitetin e saj juridik.

Përfundim

Vendimi i datës 10.08.2026 nuk e përmbush standardin minimal të një vendimi të arsyetuar, sepse:

nuk e ka konstatuar plotësisht gjendjen faktike, nuk i ka administruar provat në mënyrë transparente, nuk i ka trajtuar pretendimet sipas përmbajtjes së tyre reale, nuk ka paraqitur kalkulime konkrete, nuk ka sqaruar kundërthëniet financiare, nuk ka verifikuar në mënyrë të dokumentuar vlefshmërinë e certifikatave, nuk ka arsyetuar ligjshmërinë e konfidencialitetit, nuk ka trajtuar zbatimin e nenit 61 të LPP-së, e ka zhvendosur në mënyrë të kundërligjshme barrën e provës te Ankues dhe është mbështetur në konstatime të përgjithshme e të pakontrollueshme.

Dosja e Tenderit, Fleta e të Dhënave të Tenderit, Njoftimi për Kontratë dhe Aneksi 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, përbëjnë tërësi të pandashme të dokumentacionit të prokurimit. Kërkesat e përcaktuara në këto

dokumente kanë qenë të detyrueshme, kumulative dhe njësoj të zbatueshme ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar vetëm paraqitjen e një çmimi të përgjithshëm, por ka përcaktuar paraprakisht elementet financiare që detyrimisht duhej të përfshiheshin në formimin e çmimit të ofertës, përkatësisht:

pagën bazë prej 525.00 € bruto për secilin punëtor;

kontributin e punëdhënësit prej 5%;

shtesat për punën gjatë ndërrimit të natës dhe kontributin përkatës të punëdhënësit;

shtesat për punën gjatë vikendeve dhe kontributin përkatës të punëdhënësit;

kompensimin për punën gjatë festave zyrtare dhe kontributin përkatës;

kompensimin e orëve shtesë;

zëvendësimin e punëtorëve gjatë pushimeve vjetore;

Per secili shtes +5% kontribut

uniformat verore dhe dimërore;

pagën dhe obligimet e menaxherit/përgjegjësit, e cila nuk mund të jetë më e ulët se 525.00 € bruto;

shpenzimet operative fitimin e operatorit ekonomik TVSH-në dhe totalin përfundimtar të ofertës.

Edhe nëse, sipas sqarimeve të Autoritetit Kontraktues, operatorëve ekonomikë u është lejuar përdorimi i metodologjisë ose formatit të tyre të kalkulimit, kjo nuk i ka liruar ata nga detyrimi që në analizën financiare të përfshijnë të gjitha elementet e mësipërme. Çdo element është dashur të jetë i identifikueshëm, i përlogaritur dhe i verifikueshëm matematikisht. Prandaj, liria lidhur me formën e paraqitjes nuk mund të interpretohet si e drejtë për të anashkaluar ndonjë kosto të detyrueshme, për ta paraqitur atë në mënyrë të paidentifikueshme ose për të përdorur një çmim të përgjithshëm nga i cili nuk mund të verifikohet përmbushja e kërkesave të Dosjes së Tenderit. Aneksi 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme ka përcaktuar qartë se analiza financiare përbën kusht obligativ të ofertës. Rrjedhimisht, edhe një ofertë vetëm për një cent më e lirë nuk mund të shpallet fituese nëse çmimi i saj është krijuar duke mos përfshirë ndonjërin nga elementet e detyrueshme ose nëse analiza financiare nuk është përpiluar në përputhje me kërkesat paraprake të Autoritetit Kontraktues. Në një rast të tillë, çmimi më i ulët nuk përbën përparësi konkurruese të ligjshme, por rezultat të mosrespektimit të parametrave të përbashkët financiarë. Një ofertë e tillë duhet të eliminohet si e papërgjegjshme, pavarësisht nëse dallimi është një cent apo disa mijëra euro.

Sipas pikës 30.1 të FDT-së, kriteri për dhënien e kontratës ka qenë “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Ky kriter përmban dy kushte që zbatohen sipas një rendi të detyrueshëm:

së pari, duhet të vërtetohet se tenderi është plotësisht i përgjegjshëm dhe i përmbush të gjitha kërkesat e

dokumentacionit të tenderit;

vetëm pas këtij verifikimi mund të krahasohen çmimet ndërmjet tenderëve të përgjegjshëm.

Autoriteti Kontraktues e ka përmbysur këtë rend ligjor, duke i dhënë përparësi çmimit nominalisht më të ulët pa demonstruar paraprakisht, zë për zë dhe me kalkulim të verifikueshëm, se ofertat përkatëse i mbulojnë të gjitha kostot e detyrueshme.

TABELA KRAHASUESE E OFERTAVE

Operatori ekonomik	Oferta (€)	Oferta e MEB L.L.C. (€)	Diferenca (€)	Çështja që kërkon verifikim
SCORPION GROUP SH.P.K.	111,694.08	121,509.12	9,815.04	Përfshirja e plotë e të gjitha pagave, shtesave, kontributeve, zëvendësimeve, uniformave, pagës së menaxherit, shpenzimeve, fitimit dhe TVSH-së
BESA SECURITY SH.P.K.	115,211.52	121,509.12	6,297.60	Përputhshmëria e analizës financiare me kërkesat obligative të FDT-së dhe Aneksit 1
INTERNAT SECURITY ASSOCIATION SH.P.K.	118,037.76	121,509.12	3,471.36	Identifikimi dhe verifikimi i secilës kosto të detyrueshme
BOLD SECURITY SH.P.K. & DEFENCE SECURITY SH.P.K.	118,575.63	121,509.12	2,933.49	Përfshirja e të gjitha obligimeve të punës dhe kostove kontraktuale
SECURITY CODE	120,318.78	121,509.12	1,190.34	Përputhshmëria e plotë e çmimit me strukturën

			financiare të kërkuar
			Analizë e përpiluar mbi të gjitha kërkesat dhe parametrat e detyrueshëm të AK-së
MEB L.L.C.	121,509.12	121,509.12	0.00

Diferencat e paraqitura në tabelë nuk përdoren për të pretenduar se çdo ofertë më e ulët është automatikisht e papërgjegjshme vetëm për shkak të shumës së saj. Megjithatë, ato përbëjnë indikatorë objektivë dhe seriozë, të cilët e kanë obliguar Autoritetin Kontraktues të bëjë verifikim të detajuar, të dokumentuar dhe matematikisht të kontrollueshëm të analizës financiare të secilit operator ekonomik. Në veçanti, dallimi prej 9,815.04 € ndërmjet ofertës së SCORPION GROUP SH.P.K. dhe ofertës së MEB L.L.C. nuk mund të refuzohet me konstatimin abstrakt se “çmimi më i ulët nuk është provë e papërgjegjshmërisë”. Autoriteti Kontraktues është dashur të tregojë konkretisht se në cilat pozicione është krijuar kjo diferencë dhe si janë mbuluar, pavarësisht saj, të gjitha kostot fikse dhe obligative të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Veçanërisht domethënës është fakti se SCORPION GROUP SH.P.K. ka paraqitur çmim të njëjtë për orë prej 4.93 €, përfshirë TVSH-në, si për shërbimin 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë, ashtu edhe për shërbimin tetëorësh nga e hëna deri të premten. Këto dy pozicione nuk kanë strukturë të njëjtë të kostos, sepse pozicioni 24/7 përfshin punë gjatë natës, vikendeve dhe festave zyrtare, për të cilat Dosja e Tenderit dhe legjislacioni i punës kërkojnë pagesa shtesë.

Prandaj, aplikimi i çmimit identik për dy pozicione me ngarkesë ligjore dhe financiare të ndryshme përbën indikator të drejtpërdrejtë se është dashur të verifikohet nëse shtesat janë përfshirë realisht dhe në mënyrë të saktë. Vendimi i kundërshtuar nuk paraqet asnjë kalkulim konkret që do ta shpjegonte këtë mospërputhje. MEB L.L.C. ka paraqitur ofertën e vet duke përfshirë të gjitha kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në FDT, Njoftimin për Kontratë dhe Aneksin 1. Në bazë të dokumentacionit të disponueshëm, MEB L.L.C. është operatori i vetëm për të cilin ekziston një analizë financiare e plotë, transparente dhe e verifikueshme që dëshmon përfshirjen e të gjitha kostove të detyrueshme.

Në të kundërtën, për operatorët e tjerë, e sidomos për SCORPION GROUP SH.P.K., Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur një verifikim të tillë, ndërsa Ankuesit i është mohuar qasja në analizën financiare të operatorit të rekomanduar. Për këtë arsye, konstatimi se ofertat e tyre janë të përgjegjshme mbetet i pambështetur në prova të qasshme, konkrete dhe të kontrollueshme.

Autoriteti Kontraktues nuk mund t'i shpallë ofertat të përgjegjshme vetëm duke deklaruar se analizat financiare ekzistojnë. Ai ka qenë i detyruar të verifikojë dhe të dokumentojë:

vlerën e secilit element financiar;

formulën e përdorur;

numrin dhe strukturën e orëve;

ndarjen ndërmjet punës së rregullt, punës së natës, vikendeve dhe festave;

kontributet e punëdhënësit;

zëvendësimet gjatë pushimeve;

pagën dhe kontributet e menaxherit;

uniformat dhe shpenzimet operative;

fitimin dhe TVSH-në dhe përputhjen matematikore të këtyre elementeve me totalin e ofertuar.

Mungesa e këtij verifikimi përbën shkelje të neneve 7, 24, 27, 51, 56, 59, 60, 61 dhe 72 të LPP-së, si dhe të dispozitave përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024, lidhur me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Në bazë të nenit 59 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të ekzaminojë dhe vlerësojë secilën ofertë vetëm në përputhje me kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dokumentacionin e tenderit. Sipas nenit 60 të LPP-së, kriteri i çmimit më të ulët mund të zbatohet vetëm ndërmjet tenderëve të përgjegjshëm. Ndërkaq, sipas nenit 61 të LPP-së, kur ekzistojnë indikatorë objektivë lidhur me realizueshmërinë e çmimit, Autoriteti Kontraktues duhet të zhvillojë verifikim të posaçëm dhe të dokumentuar, e jo të mjaftohet me deklarime të përgjithshme. Prandaj, vendimi i datës 10.08.2026 është i kundërligjshëm, sepse nuk dëshmon se ofertat e operatorëve të tjerë i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e FDT-së, Njoftimit për Kontratë dhe Aneksit 1. Përkundrazi, dallimet financiare dhe mungesa e një verifikimi transparent tregojnë se këto oferta nuk kanë mundur të shpallen të përgjegjshme pa u kontrolluar më parë çdo element i analizës financiare.

Për këto arsye, kërkohet nga OSHP-ja që:

të administrojë analizat financiare të të gjithë operatorëve ekonomikë;

të urdhërojë verifikimin zë për zë të secilit element të detyrueshëm të konstatojë nëse çmimet e ofertuara mbulojnë të gjitha obligimet e përcaktuara në FDT, Njoftimin për Kontratë dhe Aneksin 1; të shpallë të papërgjegjshme çdo ofertë që nuk përfshin, nuk identifikon ose nuk përlllogarit saktë qoftë edhe një element të detyrueshëm dhe pas eliminimit të ofertave të papërgjegjshme, ta zbatojë kriterin e çmimit më të ulët vetëm ndërmjet tenderëve që janë vërtetuar si plotësisht të përgjegjshëm. Nëse pas administrimit të plotë të provave vërtetohet se analizat financiare të operatorëve të tjerë nuk i përmbajnë të gjitha elementet obligative, atëherë MEB L.L.C. mbetet tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm që ka përmbushur kërkesat financiare të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Në atë rast, vazhdimi i rekomandimit në favor të SCORPION GROUP SH.P.K. do të përbënte shkelje të drejtpërdrejtë të dokumentacionit të tenderit, të trajtimit të barabartë dhe të dispozitave të LPP-së që rregullojnë ekzaminimin, vlerësimin dhe dhënien e kontratës.

IV. SHKELJA E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË DHE MOSDISKRIMINIMIT – NENI 7 I LPP-së

Një nga shkeljet më të rënda dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e kësaj procedure qëndron në aplikimin selektiv dhe jokonsistent të kërkesave të Dosjes së Tenderit nga Autoriteti Kontraktues. Neni 7 i LPP-së nuk përmbushet vetëm duke ua mundur operatorëve ekonomikë qasjen formale në të njëjtin Njoftim për Kontratë

dhe në të njëjtën Dosje të Tenderit. Ky nen e obligon Autoritetin Kontraktues që të gjitha kërkesat, kriteret dhe kushtet e përcaktuara paraprakisht t'i interpretojë, zbatojë dhe verifikojë sipas të njëjtit standard juridik, teknik dhe financiar ndaj çdo operatori ekonomik, pa favorizim, diskriminim ose lehtësim selektiv të kërkesave.

Në kuptim të nenit 7 të LPP-së, ndalohet jo vetëm diskriminimi i drejtpërdrejtë, por edhe çdo veprim apo mosveprim i Autoritetit Kontraktues që, përmes përdorimit të standardeve të ndryshme të vlerësimit, vendos një operator ekonomik në pozitë më të favorshme sesa operatorët e tjerë. Në rastin konkret, trajtimi i pabarabartë dëshmohet veçanërisht përmes praktikës së mëparshme të vetë Autoritetit Kontraktues në aktivitetin për të njëjtin shërbim: “Sigurimi fizik i objektit të Spitalit të Përgjithshëm Vushtrri”.

Në procedurën e mëparshme, e trajtuar edhe pranë OSHP-së në lëndën 2024/0570, Autoriteti Kontraktues dhe organet e shqyrtimit e kanë trajtuar analizën financiare si dokument material dhe përcaktues për vërtetimin e përgjegjshmërisë së ofertës. Në atë procedurë janë shqyrtuar në mënyrë të hollësishme: paga bazë e punëtorëve; kontributet e punëdhënësit; orët e punës gjatë natës; puna gjatë vikendeve; puna gjatë festave zyrtare; orët shtesë; pushimet vjetore; pushimet mjekësore; kostot e zëvendësimit të punëtorëve; uniformat verore dimerore, për secilin shtesë 5% kontributet; paga dhe kontributet e menaxherit; shpenzimet operative; fitimi i operatorit ekonomik; TVSH-ja; dhe përputhja matematikore e këtyre elementeve me çmimin përfundimtar të ofertës. Në aktivitetin e mëparshëm, mënyra e përlllogaritjes së këtyre elementeve nuk është konsideruar çështje formale apo e parëndësishme. Përkundrazi, ajo është trajtuar si element thelbësor për të përcaktuar nëse çmimi i ofertuar ishte real, i realizueshëm dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me obligimet ligjore që burojnë nga marrëdhënia e punës. Autoriteti Kontraktues kishte konsideruar se mospërfshirja, përlllogaritja e pasaktë ose pamundësia e mbulimit të ndonjërit prej elementeve të detyrueshme financiare mund ta bënte ofertën të papërgjegjshme dhe mund të aktivizonte detyrimin për verifikim sipas nenit 61 të LPP-së.

Në procedurën aktuale, ndërkaq, Autoriteti Kontraktues ka devijuar pa asnjë arsyetim objektiv nga ky standard. Ai ka pranuar si të përgjegjshme ofertën e SCORPION GROUP SH.P.K., ndonëse:

Ankuesit nuk i është lejuar qasje në analizën financiare të këtij operatori;

nuk është publikuar ose ofruar një version i redaktuar i analizës financiare;

nuk është ofruar përmbledhje jokonfidenciale e të dhënave të saj;

nuk është paraqitur verifikim zë për zë i kostove të detyrueshme;

nuk është shpjeguar se si çmimi përfundimtar i mbulon të gjitha pagat, kontributet, shtesat, zëvendësimet, uniformat, pagën e menaxherit, shpenzimet, fitimin dhe TVSH-në nuk është arsyetuar aplikimi i çmimit identik për orë për shërbimin 24/7 dhe për shërbimin tetëorësh nga e hëna deri të premten dhe nuk është demonstruar nëse është zhvilluar verifikimi i nevojshëm sipas nenit 61 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, shtrohet pyetja juridike vendimtare:

Si mundet që i njëjti Autoritet Kontraktues, për të njëjtin lloj shërbimi, në procedurën e mëparshme t'i trajtojë pagat, shtesat, kontributet, zëvendësimet, menaxherin, fitimin dhe TVSH-në si elemente esenciale dhe përcaktuese të përgjegjshmërisë së ofertës, ndërsa në procedurën aktuale ta konsiderojë të mjaftueshëm një konstatim të përgjithshëm se analiza financiare e operatorit të rekomanduar “i përmban elementet e kërkuara”, pa paraqitur

asnjë vlerë, formulë ose kalkulim konkret?

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje juridikisht të qëndrueshme për këtë kontradiktë. Vendimi i datës 10.08.2026 nuk shpjegon përse standardi rigoroz i zbatuar në procedurën e mëparshme nuk është zbatuar edhe në procedurën aktuale.

Kjo mospërputhje bëhet edhe më serioze për faktin se në të dyja procedurat bëhet fjalë për të njëjtin Autoritet Kontraktues, për shërbim të njëjtë ose esencialisht të njëjtë dhe për kosto të së njëjtës natyrë juridike dhe ekonomike. Prandaj, nuk ekziston asnjë bazë objektive që kërkesat financiare të interpretohen në mënyrë strikte në një procedurë dhe në mënyrë tolerante në procedurën tjetër.

Autoriteti Kontraktues nuk mund:

ndaj MEB L.L.C. të zbatojë standard rigoroz të dëshmimit dhe verifikimit;

ndaj SCORPION GROUP SH.P.K. të mjaftohet me konstatime të përgjithshme dhe të pakontrollueshme;

ta mbajë të fshehur analizën financiare të operatorit të rekomanduar; dhe

njëkohësisht ta ngarkojë Ankuesin me barrën për të provuar mangësitë e një dokumenti në të cilin vetë Autoriteti Kontraktues ia ka pamundësuar qasjen.

Një qasje e tillë përbën përdorim të standardit të dyfishtë të vlerësimit. Autoriteti Kontraktues, praktikisht, i ka kërkuar Ankuesit prova të drejtpërdrejta për dokumentacionin e fshehur, ndërsa operatorit të rekomanduar i ka pranuar dokumentacionin pa e ekspozuar atë ndaj të njëjtit nivel transparence dhe verifikimi.

Ky veprim cenon barazinë procedurale dhe krijon avantazh të pajustificueshëm për SCORPION GROUP SH.P.K., sepse oferta e këtij operatori është mbrojtur nga kontrolli efektiv, ndërsa pretendimet e MEB L.L.C. janë refuzuar pikërisht për mungesë të provave që Autoriteti Kontraktues nuk i ka lejuar të sigurohen.

Parimi i trajtimit të barabartë kërkon që ofertat të vlerësohen në bazë të përmbajtjes së tyre reale dhe sipas kritereve të njëjta të përcaktuara para hapjes së tenderëve. Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet që, pas hapjes së ofertave dhe pasi janë bërë të njohura çmimet dhe identiteti i tenderuesve, ta zbusë, ndryshojë ose interpretojë ndryshe një kërkesë obligative në favor të një operatori të caktuar.

Çdo tolerim pas hapjes së ofertave i një mangësie që, po të paraqitej në ofertën e operatorit tjetër, do të sillte eliminimin e tij, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 7 të LPP-së. E njëjta vlen edhe për pranimin e një analize financiare që nuk mund të kontrollohet nëse përfshin dhe përllogarit të gjitha elementet e përcaktuara në FDT, Njoftimin për Kontratë dhe Aneksin 1.

Nëse MEB L.L.C. është obliguar ta ndërtojë çmimin duke përfshirë të gjitha kostot e detyrueshme, të njëjtin detyrim e kanë pasur edhe SCORPION GROUP SH.P.K. dhe operatorët e tjerë. Asnjë operator nuk mund të përfitojë avantazh financiar duke anashkaluar ose nënvlerësuar ndonjë kosto që operatorët e tjerë e kanë përfshirë në pajtim me kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, edhe një çmim vetëm për një cent më i ulët nuk mund të përdoret për dhënien e kontratës nëse ai është

rezultat i mospërfshirjes ose përlllogaritjes së pasaktë të ndonjë elementi të detyrueshëm. Në një rast të tillë nuk kemi konkurrencë të ligjshme në çmim, por trajtim të pabarabartë të operatorëve që i kanë respektuar kërkesat përballë operatorëve që nuk i kanë respektuar ato.

Vendimi i kundërshtuar bie në kundërshtim jo vetëm me nenin 7 të LPP-së, por edhe me:

nenin 24 të LPP-së, lidhur me përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues për zhvillimin e ligjshëm të aktivitetit;

nenet 27, 51, 52 dhe 53 të LPP-së, lidhur me karakterin detyrues të kërkesave të dokumentacionit të tenderit;

nenin 56 të LPP-së, lidhur me vlerësimin në bazë të kërkesave të përcaktuara paraprakisht;

nenin 59, paragrafët 2 dhe 4 të LPP-së, lidhur me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin objektiv të tenderëve;

nenin 60 të LPP-së, sipas të cilit kriteri i çmimit më të ulët zbatohet vetëm ndërmjet tenderëve të përgjegjshëm;

nenin 61 të LPP-së, lidhur me verifikimin e realizueshmërisë së çmimit; dhe

nenin 72 të LPP-së, i cili nuk lejon që përmes sqarimeve të plotësohen ose ndryshohen elementet materiale të një oferte pas afatit për dorëzimin e tenderëve.

Praktika e mëparshme e dokumentuar në lëndën 2024/0570 nuk paraqitet si burim që e zëvendëson Dosjen e Tenderit të kësaj procedure, por si provë konkrete se vetë Autoriteti Kontraktues e ka njohur më parë rëndësinë materiale të analizës financiare dhe domosdoshmërinë e verifikimit të çdo elementi të saj.

Devijimi nga ky standard, pa arsyetim objektiv, proporcional dhe të mbështetur në prova, dëshmon arbitraritet në vlerësim dhe cenon sigurinë juridike, parashikueshmërinë e procedurës dhe konkurrencën e ndershme.

Për këto arsye, kërkohet nga OSHP-ja që:

ta konstatojë shkeljen e nenit 7 të LPP-së;

ta krahasojë standardin e aplikuar në procedurën aktuale me standardin e dokumentuar në aktivitetin e mëparshëm dhe në lëndën 2024/0570;

ta administrojë të plotë analizën financiare të SCORPION GROUP SH.P.K. dhe të operatorëve të tjerë;

të verifikojë nëse secili element i kërkuar në FDT, Njoftimin për Kontratë dhe Aneksin 1 është përfshirë dhe përlllogaritur saktë;

të mos lejojë plotësimin ose ndryshimin material të analizave financiare përmes nenit 72 të LPP-së;

ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 10.08.2026 dhe Formularin B58; dhe

aktivitetin e prokurimit ta kthejë në rivlerësim të plotë, objektiv dhe të barabartë, duke zbatuar të njëjtin standard

juridik dhe financiar ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Nëse gjatë këtij verifikimi konstatohet se SCORPION GROUP SH.P.K. ose ndonjë operator tjetër nuk ka përfshirë apo nuk ka përllogaritur saktë qoftë edhe një nga elementet e detyrueshme të analizës financiare, oferta përkatëse duhet të shpallet e papërgjegjshme dhe të mos merret në konsideratë për dhënien e kontratës.

V. PRAKTIKA E MËPARSHME E VETË AUTORITETIT KONTRAKTUES ËSHTË PROVË E RËNDËSISHME PËR STANDARDIN E VLERËSIMIT

Në aktivitetin e mëparshëm të prokurimit për të njëjtin objekt dhe lloj shërbimi – **“Sigurimi fizik i objektit të Spitalit të Përgjithshëm Vushtrri”** – Autoriteti Kontraktues kishte zbatuar një standard të hollësishëm dhe rigoroz gjatë ekzaminimit të analizave financiare.

Në atë procedurë, Autoriteti Kontraktues nuk ishte mjaftuar me ekzistencën formale të një dokumenti të emërtuar **“Analizë financiare”**, por kishte shqyrtuar përmbajtjen materiale, saktësinë matematikore dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në mënyrë konkrete, Autoriteti Kontraktues kishte verifikuar:

pagën bazë të punëtorëve; kontributet e punëdhënësit; orët e punës gjatë natës; punën gjatë vikendeve; punën gjatë festave zyrtare; orët shtesë; pushimet vjetore dhe mjekësore; kostot e zëvendësimit të punëtorëve; për secilin kosto shtese 5% kontribut; uniformat 2 pale dimerore 2 pale verore pagën dhe kontributet e menaxherit; shpenzimet operative fitimin; TVSH-në; dhe përputhjen e të gjitha këtyre elementeve me çmimin përfundimtar të ofertës.

Pas këtij ekzaminimi, Autoriteti Kontraktues kishte konstatuar se mospërputhjet në analizën financiare nuk përbënin mangësi të parëndësishme ose thjesht formale, por ndikonin drejtpërdrejt në përgjegjshmërinë dhe realizueshmërinë e ofertës. Autoriteti Kontraktues kishte mbajtur qëndrimin se analiza financiare duhej të dëshmonte qartë, konkretisht dhe në mënyrë të verifikueshme mbulimin e të gjitha kostove të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Për pasojë, oferta që nuk i përmbushte këto kërkesa ishte konsideruar e papërgjegjshme dhe ishte trajtuar edhe në raport me nenin 61 të LPP-së.

Kjo praktikë është e dokumentuar në materialet e aktivitetit të mëparshëm, përfshirë **Raportin e Ekspertit Shqyrtues dhe Vendimin e OSHP-së në lëndën 2024/0570**, të cilat i bashkëngjiten kësaj ankese si prova materiale.

Ankuesi nuk pretendon se një vendim i mëparshëm i Autoritetit Kontraktues krijon precedent juridik formalisht të detyrueshëm. Megjithatë, ai përbën provë të drejtpërdrejtë dhe relevante për:

mënyrën se si vetë Autoriteti Kontraktues e ka interpretuar rëndësinë e analizës financiare;

standardin e verifikimit të zbatuar më parë për të njëjtin lloj shërbimi;

natyrën materiale të pagave, shtesave, kontributeve dhe kostove të tjera;

domosdoshmërinë e verifikimit të secilit element të analizës financiare; dhe

pasojën juridike të mospërfshirjes ose përllogaritjes së pasaktë të një elementi të detyrueshëm.

Autoriteti Kontraktues nuk mundet që, për të njëjtin shërbim, në një procedurë t'i trajtojë këto elemente si esenciale dhe përcaktuese për përgjegjshmërinë e ofertës, ndërsa në procedurën aktuale të mjaftohet me një konstatim të përgjithshëm se analiza financiare e SCORPION GROUP SH.P.K. “i përmban elementet e kërkuara”.

Përfshirja formale e emërimit të një kostoje nuk dëshmon se ajo është llogaritur në mënyrë të saktë dhe të plotë. Përmbushja e kërkesës mund të vërtetohet vetëm nëse nga analiza financiare rezultojnë qartë:

baza e kalkulimit; numri dhe struktura e orëve; norma përkatëse e pagesës; përqindja e secilës shtesë; kontributet e punëdhënësit; numri i punëtorëve; periudha e realizimit; vlera e secilit element; dhe përputhja matematikore me totalin e ofertuar.

Edhe nëse, sipas sqarimeve të dhëna në procedurën aktuale, operatorëve u është lejuar përdorimi i metodologjisë ose formatit të tyre të kalkulimit, kjo liri ka të bëjë vetëm me formën e paraqitjes. Ajo nuk e eliminon detyrimin për përfshirjen e të gjitha elementeve të përcaktuara në FDT, Njoftimin për Kontratë dhe Aneksin 1.

Çdo metodologji e përdorur duhet të mundësojë identifikimin dhe verifikimin e secilës kosto. Një metodologji tjetër ndikon në përgjegjshmërinë e ofertës nëse përmes saj:

anashkalohet ndonjë element i detyrueshëm;

bashkohen kostot në mënyrë që ato të mos mund të verifikohen;

përdoren norma në kundërshtim me kërkesat;

nuk dëshmohet mbulimi i obligimeve ligjore; ose

krijohet mospërputhje ndërmjet kalkulimit dhe totalit të ofertës.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk mund ta përdorë lejimin e një metodologjie tjetër si bazë për tolerimin e mungesës, nënvlerësimit ose përllogaritjes së pasaktë të ndonjë kostoje obligative.

Në procedurën aktuale, Autoriteti Kontraktues nuk ka treguar:

përse ka devijuar nga standardi i mëparshëm i verifikimit;

cilat rrethana faktike ose juridike e arsyetojnë këtë devijim;

si është verifikuar secili element i analizës financiare të SCORPION GROUP SH.P.K.;

cilat formula dhe vlera janë kontrolluar si është konstatuar se oferta i mbulon të gjitha obligimet ligjore dhe kontraktuale; dhe si mundet çmimi identik prej 4.93 € për orë ta mbulojë njëkohësisht shërbimin 24/7 dhe shërbimin tetëorësh, ndonëse këto pozicione kanë strukturë të ndryshme të kostove.

Vendimi i datës 10.08.2026 nuk përmban asnjë arsyetim konkret për ndryshimin e këtij standardi. Ai nuk

ballafaqohet fare me praktikën e mëparshme dhe nuk shpjegon përse elementet që në procedurën paraprake janë konsideruar materiale, në procedurën aktuale trajtohen vetëm përmes deklarimeve të përgjithshme dhe të pakontrollueshme.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar interpretimin e vet, ka pasur detyrim që:

ta identifikojë shprehimisht ndryshimin;

ta mbështesë atë në dispozita konkrete të LPP-së dhe dokumentacionin e procedurës;

të paraqesë arsyet objektive që e justifikojnë ndryshimin;

ta zbatojë standardin e ri në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve; dhe

ta pasqyrojë këtë analizë në arsyetimin e vendimit.

Asnjëra nga këto kërkesa nuk është përmbushur.

Devijimi i paarsyetuar nga praktika e mëparshme cenon sigurinë juridike, parashikueshmërinë e procedurës, transparencën dhe trajtimin e barabartë. Ai krijon dyshim objektiv se standardi i vlerësimit është ndryshuar pas hapjes së ofertave dhe pasi Autoriteti Kontraktues është njohur me çmimet dhe identitetin e tenderuesve.

Autoriteti Kontraktues nuk mund ta interpretojë të njëjtën kategori kërkesash në mënyrë strikte kur kjo çon në eliminimin e një operatori, ndërsa në mënyrë tolerante kur një interpretim i tillë favorizon operatorin e rekomanduar për kontratë.

Një veprim i tillë përbën zbatim selektiv të Dosjes së Tenderit dhe bie në kundërshtim me:

nenin 7 të LPP-së, për trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin;

nenin 24 të LPP-së, lidhur me përgjegjësinë për zhvillimin e ligjshëm të aktivitetit;

nenin 56 të LPP-së, lidhur me vlerësimin sipas kërkesave të përcaktuara paraprakisht;

nenin 59 të LPP-së, lidhur me ekzaminimin dhe vlerësimin objektiv të tenderëve;

nenin 60 të LPP-së, sipas të cilit çmimi më i ulët zbatohet vetëm ndërmjet tenderëve të përgjegjshëm; dhe

nenin 61 të LPP-së, lidhur me verifikimin e realizueshmërisë së çmimit të ofertuar.

Për këto arsye, kërkohet nga OSHP-ja që ta administrojë dokumentacionin e aktivitetit të mëparshëm dhe lëndën **2024/0570** si prova krahasuese relevante, të vlerësojë ndryshimin e standardit të aplikuar nga Autoriteti Kontraktues dhe të konstatojë se vendimi i kundërshtuar është nxjerrë mbi bazën e një vlerësimi jokonsistent, selektiv dhe të paarsyetuar. Në mungesë të një arsyetimi objektiv dhe ligjor për ndryshimin e standardit, Vendimi i datës 10.08.2026 dhe rekomandimi për dhënien e kontratës nuk mund të qëndrojnë juridikisht dhe duhet të

anulohen.

VI. SHKELJA E NENIT 59 TË LPP-së – EKZAMINIMI, VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE

Neni 59 i LPP-së përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Në veçanti, paragrafi 4 i nenit 59 përcakton se tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit. Rregullorja Nr. 001/2022 e konkretizon më tej këtë standard dhe përcakton se gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit duhet të respektohen kërkesat e dokumenteve të prokurimit dhe se tenderët e përgjegjshëm duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë.

Në rastin konkret, AK ka dështuar të demonstrojë në mënyrë të mjaftueshme:

- cilat janë të gjitha elementet e analizës financiare të SCORPION GROUP SH.P.K.;
- si janë kalkuluar ato;
- nëse kalkulimi përputhet me kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit;
- nëse të gjitha kostot ligjore dhe kontraktuale janë përfshirë;
- nëse numri i orëve përputhet me kërkesën e AK-së;
- nëse pagat dhe shtesat janë kalkuluar sipas kërkesave;
- nëse pushimet, festat, vikendet dhe orët e natës janë trajtuar sipas kërkesave;
- nëse janë përfshirë kostot e menaxherit;
- dhe nëse çmimi i ofertuar mund të konsiderohet realisht i zbatueshëm për realizimin e kontratës.

Thjesht konstatimi se “nuk është identifikuar ndonjë element konkret që mungon” **nuk e zëvendëson analizën e detajuar që duhet ta bëjë vetë Komisioni i Vlerësimit.**

VII. ANALIZA FINANCIARE – ARSYETIMI I AK-së ËSHTË KONTRADIKTOR ME PRAKTIKËN E TIJ

Autoriteti Kontraktues, në Vendimin e datës 10.08.2026, e pranon shprehimisht se Dosja e Tenderit ka kërkuar që analiza financiare e secilit operator ekonomik të përmbajë elemente konkrete dhe të detyrueshme, përfshirë:

- pagën bazë prej 525.00 € bruto;
- kontributin e punëdhënësit;
- shtesat për punën gjatë natës;
- shtesat për punën gjatë vikendeve;
- kompensimin për festat zyrtare;
- kompensimin e orëve shtesë;
- zëvendësimin gjatë pushimeve vjetore;

- Per secilin kosto +5% kontributet;
- uniformat;
- pagën dhe obligimet e menaxherit;
- shpenzimet operative;
- fitimin;
- TVSH-në; dhe
- totalin përfundimtar të ofertës.

Ky pranim i Autoritetit Kontraktues ka rëndësi thelbësore juridike, sepse vërteton se këto elemente nuk kanë qenë fakultative dhe as të parëndësishme. Ato kanë përbërë kërkesa obligative të dokumentacionit të tenderit dhe, rrjedhimisht, kushte materiale për përcaktimin e përgjegjshmërisë së secilës ofertë. Megjithatë, në vend që të demonstrojë se analiza financiare e **SCORPION GROUP SH.P.K.** i përmbush realisht dhe matematikisht këto kërkesa, Autoriteti Kontraktues është kufizuar në deklaratimet e përgjithshme se analiza financiare “është shqyrtuar” dhe se “nuk është konstatuar ndonjë mangësi konkrete”. Një arsyetim i tillë nuk e përmbush standardin e kërkuar nga **nenet 24, 56, 59 dhe 60 të LPP-së**. Deklarimi se dokumenti është shqyrtuar nuk përbën provë se shqyrtimi është kryer në mënyrë të plotë, objektive dhe të ligjshme.

Në një aktivitet ku analiza financiare është përcaktuar si pjesë obligative e ofertës, Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar të përgjigjet konkretisht:

1. Çfarë vlere është kalkuluar për secilin element?
2. Cila formulë dhe cilët parametra janë përdorur?
3. Sa orë të rregullta, të natës, të vikendeve, të festave dhe orë shtesë janë përfshirë?
4. A janë përfshirë kontributet e punëdhënësit për secilën pagesë përkatëse?
5. Si janë llogaritur pushimet dhe zëvendësimet e punëtorëve?
6. Si janë përfshirë uniformat, paga e menaxherit dhe shpenzimet operative?
7. Sa është fitimi konkret i operatorit ekonomik?
8. Si është llogaritur TVSH-ja?
9. A përputhet shuma e të gjitha elementeve me çmimin përfundimtar të ofertës?
10. Nëse ekziston mospërputhje, përse ajo nuk ndikon në përgjegjshmërinë e ofertës?

Vendimi i kundërshtuar nuk jep përgjigje të verifikueshme për asnjërën nga këto çështje. Ai nuk paraqet asnjë formulë, vlerë, tabelë, ndarje të orëve apo kalkulim financiar që do ta mbështeste përfundimin se oferta e **SCORPION GROUP SH.P.K.** është e përgjegjshme.

Në vend të analizës së këtyre çështjeve, Autoriteti Kontraktues është përpjekur ta zhvendosë diskutimin te pretendimi se **MEB L.L.C. ka synuar të realizojë fitim më të lartë**.

Ky konstatim është faktikisht i pasaktë, juridikisht i parëndësishëm dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me analizën financiare të dorëzuar nga **MEB L.L.C.**

FITIMI REAL I MEB L.L.C.

Nga analiza financiare e MEB L.L.C. rezulton se është paraparë fitim prej vetëm:

Përshkrimi	Vlera
Fitimi mujor për një punëtor	1.00 €
Numri i punëtorëve/rojeve	5
Fitimi i përgjithshëm mujor	5.00 €
Fitimi për periudhën 24-mujore	120.00 €

Pra, MEB L.L.C. nuk ka ndërtuar ofertën mbi një marzhë të lartë fitimi. Përkundrazi, fitimi i përgjithshëm i paraparë është vetëm **5.00 € në muaj për pesë punëtorë**, përkatësisht **120.00 € për tërë periudhën 24-mujore të kontratës**. Kjo provë e rrëzon plotësisht arsyetimin e Autoritetit Kontraktues se dallimi ndërmjet ofertës së MEB L.L.C. dhe ofertës së SCORPION GROUP SH.P.K. buron nga dëshira e Ankuesit për të realizuar fitim më të lartë. Diferenca prej **9,815.04 €** ndërmjet dy ofertave nuk mund të shpjegohet me fitimin prej vetëm **120.00 €** të MEB L.L.C. Edhe nëse fitimi i MEB L.L.C. do të hiqej tërësisht nga oferta, diferenca do të mbetej **9,695.04 €**.

Përshkrimi	Vlera (€)
Oferta e MEB L.L.C.	121,509.12
Oferta e SCORPION GROUP SH.P.K.	111,694.08
Diferenca ndërmjet ofertave	9,815.04
Fitimi total i MEB L.L.C. për 24 muaj	120.00
Diferenca pas heqjes së plotë të fitimit të MEB L.L.C.	9,695.04

Kjo llogaritje dëshmon se diferenca ndërmjet ofertave nuk ka buruar nga fitimi i MEB L.L.C., por krijon dyshim serioz dhe objektiv se në ofertën e SCORPION GROUP SH.P.K.:

- nuk është përfshirë ndonjë element i detyrueshëm;
- ndonjë kosto është nënvlerësuar;
- shtesat ligjore nuk janë përllogaritur plotësisht;
- kostot e pozicionit 24/7 janë trajtuar njësoj me pozicionin tetëorësh; ose
- kalkulimi nuk përputhet me metodologjinë dhe parametrat obligativë të dokumentacionit të tenderit.

Autoriteti Kontraktues e ka deformuar pretendimin e Ankuesit. MEB L.L.C. nuk ka pretenduar se Dosja e Tenderit

ka përcaktuar një fitim minimal dhe as nuk ka kërkuar që operatorët ekonomikë të realizojnë fitim të njëjtë. Pretendimi i MEB L.L.C. është krejtësisht tjetër: **edhe me një fitim pothuajse simbolik prej vetëm 1.00 € në muaj për punëtor, oferta e saj arrin në 121,509.12 €, sepse përfshin të gjitha kostot e detyrueshme të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.** Prandaj, përgjigjja e Autoritetit Kontraktues se “nuk është përcaktuar fitim minimal” nuk i përgjigjet fare pretendimit të ngritur. Ajo përbën shmangie nga çështja juridike dhe financiare që është dashur të shqyrtohej. Çështja nuk është se sa fitim duhet të realizojë një operator. Çështja është nëse, pas mbulimit të pagave, kontributeve, shtesave, pushimeve, zëvendësimeve, uniformave, pagës së menaxherit, shpenzimeve operative dhe TVSH-së, oferta e rekomanduar lë fare hapësirë për fitim dhe për realizimin e qëndrueshëm të kontratës.

Në vend që ta kryente këtë verifikim, Autoriteti Kontraktues ka paraqitur një pretendim të pabazuar për “fitim më të lartë” të MEB L.L.C., pa e krahasuar atë me të dhënat e analizës financiare që i kishte në dispozicion.

Kjo tregon se Vendimi i datës 10.08.2026:

- nuk është mbështetur në gjendjen reale faktike;
- nuk e ka analizuar provën financiare të MEB L.L.C.;
- e ka shtrembëruar pretendimin e Ankuesit;
- nuk e ka verifikuar burimin real të diferencës ndërmjet ofertave;
- nuk e ka analizuar realizueshmërinë e çmimit të rekomanduar; dhe
- nuk ka dhënë arsyetim konkret për përgjegjshmërinë e SCORPION GROUP SH.P.K.

PROVË SHITESË – ANALIZA FINANCIARE E MEB L.L.C.

Në vijim të kësaj ankese, MEB L.L.C. bashkëngjit si provë materiale **Analizën e saj Financiare**, të përpiluar në mënyrë të detajuar, transparente dhe matematikisht të verifikueshme, në përputhje të plotë me kërkesat e Autoritetit Kontraktues, Dosjen e Tenderit, Fletën e të Dhënave të Tenderit, Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme dhe dispozitat përkatëse të Ligjit të Punës. Analiza financiare e MEB L.L.C. dëshmon se në çmimin e ofertuar janë përfshirë të gjitha kostot e detyrueshme, përfshirë pagën bazë prej 525.00 € bruto, kontributin e punëdhënësit, shtesat për punën gjatë natës, vikendeve dhe festave zyrtare, orët shtesë, zëvendësimet gjatë pushimeve vjetore, uniformat, pagën dhe obligimet e menaxherit, për secilin kosto +5% kontributi sipas kërkesës në FDT shpenzimet operative, fitimin, TVSH-në dhe totalin përfundimtar të ofertës. **Rëndësia e kësaj analize është vendimtare, sepse Autoriteti Kontraktues në FDT, Dosjen e Tenderit dhe Aneksin 1 ka theksuar në së paku pesë raste se analiza financiare dhe çmimi duhet të përpilohen dhe përlllogariten sipas kërkesave të përcaktuara paraprakisht. Përsëritja e kësaj kërkeje dëshmon se analiza financiare nuk ka qenë dokument formal apo fakultativ, por kusht thelbësor dhe obligativ për përgjegjshmërinë e ofertës.** Nga analiza krahasuese e çmimeve dhe dokumentacionit të disponueshëm rezulton se, përveç MEB L.L.C., asnjë operator tjetër ekonomik nuk ka dëshmuar në mënyrë të plotë, transparente dhe të verifikueshme se e ka përpiluar analizën financiare sipas të gjitha kërkesave obligative të Autoritetit Kontraktues. Prandaj, MEB L.L.C. është operatori i vetëm që ka dëshmuar përmbushjen e plotë të kërkesave financiare të përcaktuara në FDT, Dosjen e Tenderit dhe Aneksin 1. Çdo ofertë tjetër që nuk përmban ose nuk përlllogarit saktë qoftë edhe një element të detyrueshëm duhet të shpallet e papërgjegjshme dhe të eliminohet nga procedura, në përputhje me nenet 56, 59 dhe 60 të LPP-së.

Provë: Analiza Financiare e MEB L.L.C., e bashkëngjitur kësaj ankese

Pershkrimi	Vlera / Shuma
Paga TOTAL BRUTO per nje punetor ne muaj	€ 525,00
5% e kontribut i kompanise	€ 26,25
Total Paga bruto + kontributi i punedhenesit	€ 551,25
Pushimi vjetor	€ 35,80
5% e kontributit per pagesen e pushimit vjetor	€ 1,79
Shpenzimet e uniformave (2 verore/2 dimerore) + kontrinuti i punedhenesit	€ 7,00
Pagesa e menaxherit	€ 120,00
TOTAL	€ 715,84
Shpenzime operative mujore + fitimi	€ 1,00
Total paga + shpenzime operative	€ 716,84
TVSH	€ 129,03
Total çmimi me tvsh per 1 muaj	€ 845,87
Çmimi mesatar per nje ore pune per roje me TVSH	€ 4,81

Analiza Financiare - 1 pike roje 24 ore x 7 dite ne jave

Pershkrimi	Vlera / Shuma
Paga TOTAL BRUTO per nje punetor ne muaj	€ 525,00
5% e kontribut i kompanise	€ 26,25
Total Paga bruto + kontributi i punedhenesit	€ 551,25
Pagesa shtese per ndrrimet e nates	€ 34,09

5% e pageses shtese per ndrrimet e nates	€ 1,70
Pagesa shtese gjate vikendit	€ 57,87
5% per pagesen gjate vikendit	€ 2,89
Pagesa per oret shtese	€ 5,82
5% per pagesen per oret shtese	€ 0,29
Pagesa shtese gjate festave	€ 8,95
5% per pagesen gjate festave	€ 0,45
Zevendsimi I Pushimeve vjetor	€ 35,80
5% e kontributit per pagesen e zevendsimit pushimit vjetor	€ 1,79
Shpenzimet e uniformave (2 verore/2 dimerore) + kontrinuti i punedhenesit	€ 7,00
Pagesa e menaxherit	€ 110,25
TOTAL	€ 818,15
Shpenzime operative mujore + fitimi	€ 1,00
Total paga + shpenzime operative	€ 819,15
TVSH	€ 147,45
Total çmimi me tvsh per 1 muaj	€ 966,59
Çmimi mesatar per nje ore pune per roje me TVSH	€ 5,49

LLOGARITJA E CMIMEVE SHITESAVE SIPAS LIGJIT TE PUNES

cmimi per ore pune baze	€ 2,98
cmimi per ore pune nate	€ 0,89
cmimi per ore pune vikende	€ 1,49
cmimi per ore pune festa	€ 1,49

ORE PUNE DITE

total ore pune dite ne muaj (21 dite pune x 16 ore ne dite) pa festa 337

ore mesatare dite per nje roje (4 roje ne pike) 80,24

cmimi per ore pune - cmimi baze (525euro pjestim me 176 ore pune ne muaj) € 239,35

ORE PUNE NATE

total ore pune nate ne muaj (20 dite pune x 8 ore ne dite) 160

ore mesatare nate per nje roje (4 roje ne pike) 38,10

Pagesa shtese per ore pune nate per punetor € 34,09

ORE PUNE VIKENDI

total ore pune vikende per roje (2 dite x 24 ore x 4.34 jave) 208

ore mesatare vikendi per nje roje (4 roje ne pike) 49,52

Pagesa shtese per ore pune nate per punetor € 57,87

ORE PUNE FESTA

total ore pune festa ne vit 12 dite mesatare 1 dite ne muaj x 24 ore 24

ore mesatare festa per nje roje (4 roje ne pike) 6

Pagesa shtese per ore pune nate per punetor € 8,95

ORET SHTESE

Total ore pune ne muaj per piken 24 ore € 730,00

ore pune per punetor (4 punetore) € 182,50

Ore pune shtese per punetor mbi 176 ore € 6,50

Pagesa per oret shtese € 5,82

PUSHIMI VJETOR

paga bruto per nje punetor	€ 525,00
mesatare per ore pune pjestim 176 ore	€ 2,98
total ore per pushim 20 dite pune x 8 ore	144
cmimi per pushim vjetor	€ 429,55
mesatare per pushim ne muaj	€ 35,80

UNIFORMAT

cmimi per 2 pale (Dimerore/Verore)	€ 42,00
4 pale	€ 84,00
cmimi mesatar mujor	€ 7,00

MENAXHERI

paga e menaxherit ne muaj	€ 551,25
mesatare perpjestim per 5 punetor	€ 110,25

LLOGARITJA FINAL

Pozicioni 1 me TVSH 24 muaj = 101.191,68

Pozicioni 2 me TVSH 24 muaj = 20.317,44

Totali tenderit 1+2 me TVSH per 24 muaj = 121.509,12

Valuta Euro

Duke pasur parasysh se analiza financiare e MEB L.L.C. është përpiluar në mënyrë identike me kërkesat obligative të Autoritetit Kontraktues dhe përfshin të gjitha kostot e përcaktuara në FDT, Dosjen e Tenderit dhe Aneksin 1, shpallja fitues e një operatori me çmim dukshëm më të ulët, pa dëshmuar se i ka përfshirë të njëjtat kosto, është e pakuptueshme, diskriminuese dhe juridikisht e paqëndrueshme. **Autoriteti Kontraktues ka kryer shkelje të dyfishtë: së pari, nuk i ka respektuar kriteret obligative që vetë i ka përcaktuar; së dyti, nuk i ka zbatuar ato në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Çmimi më i ulët nuk mund të**

ketë përparësi ndaj një oferte të përgjegjshme nëse është krijuar duke anashkaluar pagat, kontributet, shtesat dhe kostot e tjera të detyrueshme.Një veprim i tillë përbën shkelje të neneve 7, 56, 59 dhe 60 të LPP-së. Prandaj, oferta e rekomanduar dhe çdo ofertë tjetër që nuk i përmbush plotësisht kërkesat e Autoritetit Kontraktues duhet të eliminohen si të papërgjegjshme.

VETËM MEB L.L.C. KA DËSHMUAR PËRGJEGJSHMËRINË E PLOTË FINANCIARE

Nga provat e disponueshme në këtë procedurë rezulton se vetëm MEB L.L.C. ka paraqitur analizë financiare transparente dhe matematikisht të verifikueshme, e cila dëshmon përfshirjen e të gjitha kërkesave të përcaktuara në:

- Njoftimin për Kontratë;
- Fletën e të Dhënave të Tenderit;
- Dosjen e Tenderit; dhe
- Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

Për operatorët e tjerë, përfshirë SCORPION GROUP SH.P.K., nuk është paraqitur një verifikim i tillë. Në veçanti, analiza financiare e operatorit të rekomanduar është mbajtur e paarritshme për Ankuesin, ndërsa Vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk përmban të dhëna të mjaftueshme që do ta zëvendësonin qasjen dhe do ta mundësonin kontrollin objektiv të saj. Në këto rrethana, nuk ekziston bazë faktike dhe juridike që ofertat e operatorëve të tjerë të konsiderohen të përgjegjshme vetëm mbi konstatimin deklarativ të Autoritetit Kontraktues. Përkundrazi, deri në administrimin dhe verifikimin e plotë të analizave financiare, **MEB L.L.C. është operatori i vetëm që ka dëshmuar në mënyrë transparente, të detajuar dhe të verifikueshme se oferta e tij i përmbush të gjitha kërkesat financiare të Autoritetit Kontraktues.** Kriteri i përcaktuar në pikën 30.1 të FDT-së nuk ka qenë thjesht “çmimi më i ulët”, por **“Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”**. Prandaj, çmimi i SCORPION GROUP SH.P.K. nuk mund të marrë përparësi para se të vërtetohet plotësisht përgjegjshmëria e ofertës së tij. Nëse analiza financiare nuk dëshmon përfshirjen dhe përlllogaritjen e saktë të qoftë edhe një elementi obligativ, oferta përkatëse duhet të shpallet e papërgjegjshme, pavarësisht se sa më e ulët është në raport me ofertën e MEB L.L.C.

Mosadministrimi i këtyre provave, shtrembërimi i çështjes së fitimit dhe pranimi i ofertës së rekomanduar pa verifikim konkret përbëjnë shkelje të neneve 7, 24, 56, 59, 60 dhe 61 të LPP-së, si dhe të dispozitave përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

VIII. ÇMIMI I ULËT DHE DETYRIMI PËR VERIFIKIMIN E NJË TENDERI JO-NORMALISHT TË ULËT

Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se çmimi më i ulët, në vetvete, nuk përbën dëshmi të papërgjegjshmërisë së ofertës.

Në parim, Ankuesi pajtohet me këtë formulim.

Mirëpo, ky nuk është pretendimi i Ankuesit.

Pretendimi është se, kur ekzistojnë elemente konkrete që ngrenë dyshime për realizimin dhe për përmbushjen e detyrimeve të kërkuara nga Dosja e Tenderit me çmimin e ofruar, Autoriteti Kontraktues duhet të zbatojë

mekanizmin ligjor për tenderët jo-normalisht të ulët.

Rregullorja Nr. 001/2022 përcakton se tenderi jo-normalisht i ulët nuk mund të refuzohet automatikisht, por duhet të shqyrtohet përmes procedurës së sqarimit dhe verifikimit. Në rast se sqarimi është i mjaftueshëm, tenderi trajtohet njëjtë si tenderët e tjerë; nëse nuk është i mjaftueshëm, tenderi mund të refuzohet në pajtim me nenin 61 të LPP-së.

Prandaj, çështja nuk është nëse SCORPION GROUP SH.P.K. ka ofertuar çmimin më të ulët.

Çështja është nëse:

çmimi i ofertuar është mbështetur me një strukturë reale, të plotë dhe të verifikueshme të kostove të kërkuara nga Dosja e Tenderit si dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Nëse jo, atëherë AK nuk mund ta anashkalojë këtë çështje vetëm me konstatimin se “çmimi i ulët nuk është në vetvete provë e mjaftueshme”.

IX. DETYRIMI PËR TRAJTIM TË NJËJTË TË OFERTUESVE NË ÇËSHTJET E SQARIMEVE

Nëse Autoriteti Kontraktues, gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve, ka kërkuar ose ka pranuar sqarime nga SCORPION GROUP SH.P.K., këto veprime duhet të jenë zhvilluar në përputhje të plotë me nenin 7, nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së, si dhe me dispozitat përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. E drejta e Autoritetit Kontraktues për të kërkuar sqarime nuk është e pakufizuar. Sqarimi mund të përdoret vetëm për të qartësuar përmbajtjen ekzistuese të ofertës, por nuk mund të shndërrohet në mundësi për:

plotësimin e një kërkesë materiale që ka munguar në ofertën fillestare;

shtimin e një elementi të ri financiar;

ndryshimin e çmimit ose të strukturës së tij;

korrigjimin e metodologjisë së kalkulimit;

ndryshimin e numrit ose të kategorisë së orëve;

shtimin e kostove për natë, vikende, festa ose orë shtesë;

përfshirjen e mëvonshme të pushimeve dhe zëvendësimeve;

shtimin e pagës së menaxherit, uniformave, fitimit ose shpenzimeve operative;

zëvendësimin e një dokumenti të pavlefshëm me dokument të ri; ose

përmirësimin material të ofertës pas përfundimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Neni 59.2 i LPP-së nuk mund të përdoret për ta bërë të përgjegjshme një ofertë që në momentin e dorëzimit ka

qenë e papërgjegjshme. Sqarimi duhet të mbështetet në dokumentacionin dhe të dhënat që kanë ekzistuar në ofertën fillestare dhe nuk mund t'i japë tenderuesit mundësi që, pasi janë hapur ofertat dhe janë bërë të njohura çmimet e konkurruesve, ta rindërtojë ose përmirësojë ofertën e vet. Nëse analiza financiare e SCORPION GROUP SH.P.K. nuk ka përmbajtur që në momentin e dorëzimit ndonjërin nga elementet obligative të përcaktuara në FDT dhe Aneksin 1, kjo mungesë është materiale. Ajo nuk mund të plotësohet përmes sqarimit, sepse do të ndikonte drejtpërdrejt në strukturën e çmimit, realizueshmërinë e ofertës dhe përgjegjshmërinë e tenderit.

Në veçanti, përmes sqarimit nuk mund të ndryshohet apo plotësohet: Analiza financiare e kerkuar sipas kërkeses në FDT dhe Njoftimit për kontratë e përfshirë të gjitha elementet.

Secili prej elementeve ndikon në çmimin dhe përmbajtjen ekonomike të tenderit. Shtimi apo ndryshimi i tyre pas afatit për dorëzimin e ofertave nuk do të ishte "sqarim", por ndryshim material i ofertës.

NDALIMI I STANDARDIT TË DYFISHTË

Autoriteti Kontraktues është i obliguar ta zbatojë të njëjtin standard të sqarimit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Ai nuk mundet:

ndaj një operatori të kërkojë vetëm shpjegim të dokumenteve ekzistuese, ndërsa operatorit tjetër t'i lejojë plotësimin e dokumentacionit material;

ndaj një operatori ta konsiderojë mungesën si shkak për eliminim, ndërsa ndaj operatorit tjetër ta trajtojë të njëjtën mungesë si të sqarueshme;

ndaj MEB L.L.C. të kërkojë përputhshmëri të plotë me kërkesat fillestare, ndërsa SCORPION GROUP SH.P.K. t'i lejojë korrigjimin apo ristrukturimin e analizës financiare;

të kërkojë prova të hollësishme nga Ankuesi, ndërsa të pranojë deklaratime të përgjithshme nga operatori i rekomanduar; ose ta mbajë konfidencial komunikimin me operatorin e rekomanduar dhe njëkohësisht të pretendojë se procedura është zhvilluar në mënyrë transparente.

Nëse një mangësi do të shkaktonte eliminimin e MEB L.L.C., e njëjta mangësi duhet të prodhojë të njëjtën pasojë juridike edhe ndaj SCORPION GROUP SH.P.K. Çdo trajtim tjetër përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 7 të LPP-së. Parimi i trajtimit të barabartë kërkon jo vetëm që të njëjtat kërkesa të vlejnë për të gjithë tenderuesit, por edhe që mundësia për sqarim, përmbajtja e kërkesës për sqarim, afati për përgjigje dhe kufijtë e pranimi të dokumentacionit shtesë të aplikohen në mënyrë të njëjtë.

DOMOSDOSHMERIA E ADMINISTRIMIT TË KOMUNIKIMEVE TË SQARIMIT

Vendimi i datës 10.08.2026 nuk tregon qartë:

nëse SCORPION GROUP SH.P.K. është kërkuar të japë sqarime;

në cilën datë është kërkuar sqarimi; çfarë pyetjesh i janë parashtruar; çfarë dokumentesh ose kalkulimesh janë

kërkuar;çfarë përgjigjeje është pranuar;nëse janë dorëzuar dokumente të reja;nëse është ndryshuar apo plotësuar analiza financiare dhe nëse sqarimi ka ndikuar në konstatimin përfundimtar të përgjegjshmërisë.

Mungesa e këtyre të dhënave e pamundëson kontrollin nëse Autoriteti Kontraktues ka respektuar kufijtë e neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Për këtë arsye, OSHP-ja duhet ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të paraqesë të gjithë gjurmën dokumentare të procesit të vlerësimit, përfshirë:

çdo kërkesë për sqarim të dërguar SCORPION GROUP SH.P.K.;

çdo përgjigje të pranuar nga ky operator;

çdo dokument shtesë të dorëzuar pas afatit për tenderim;

versionin fillestar të analizës financiare;

çdo version të mëvonshëm ose të korrigjuar të saj;

procesverbalet dhe raportet e Komisionit të Vlerësimit; dhe

arsyetimin mbi bazën e të cilit është konstatuar se sqarimet nuk kanë ndryshuar materialisht ofertën.

Nëse rezulton se pas afatit për dorëzimin e tenderëve është shtuar, ndryshuar ose rillogaritur ndonjë element i analizës financiare, atëherë oferta e SCORPION GROUP SH.P.K. duhet të shpallet e papërgjegjshme. Një ndryshim i tillë nuk mund të legalizohet përmes emërimit formal “sqarim”.

RËNDËSIA E VEÇANTË E ANALIZËS FINANCIARE

Në këtë aktivitet, analiza financiare nuk është dokument dytësor. Ajo është prova kryesore që dëshmon nëse çmimi i ofertuar mbulon të gjitha detyrimet ligjore dhe kontraktuale.Pikërisht për këtë arsye, çdo ndërhyrje në analizën financiare pas dorëzimit të ofertës rrezikon ta ndryshojë pozitën konkurruese të tenderuesit. Lejimi i plotësimit të saj pas hapjes së ofertave do t'i mundësonte operatorit përkatës ta përshtaste kalkulimin pasi i kishte mësuar çmimet e konkurruesve.

Një mundësi e tillë do të cenonte:

barazinë ndërmjet tenderuesve;integritetin e procedurës;pandryshueshmërinë e ofertës pas afatit;transparencën e vlerësimit konkurrencën e ndershme dhe besueshmërinë e rezultatit përfundimtar.Prandaj, çdo paqartësi duhet të dallohet nga mungesa materiale. Një e dhënë ekzistuese mund të sqarohet, por një element që nuk ka ekzistuar në ofertën fillestare nuk mund të krijohet pas afatit.

Autoriteti Kontraktues nuk mund ta përdorë nenin 72 të LPP-së për ta rehabilituar një ofertë të papërgjegjshme dhe as nenin 59.2 për t'ia mundësuar operatorit të rekomanduar ndryshimin e përmbajtjes ekonomike të tenderit.

Për këto arsye, kërkohet nga OSHP-ja që:

të administrojë të gjitha komunikimet ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe SCORPION GROUP SH.P.K.;

të verifikojë nëse është kërkuar ose pranuar dokumentacion shtesë;

të krahasojë analizën financiare fillestare me çdo dokument të dorëzuar më vonë;

të konstatojë nëse përmes sqarimit është ndryshuar ndonjë element material i ofertës;

të verifikojë nëse standardi i njëjtë i sqarimit është aplikuar ndaj të gjithë operatorëve;

të konstatojë shkeljen e neneve 7, 59.2 dhe 72 të LPP-së nëse është lejuar plotësim apo ndryshim material; dhe

ta shpallë të papërgjegjshme çdo ofertë që është bërë e përgjegjshme vetëm pas ndërhyrjeve ose plotësimeve të palejuara pas afatit të tenderimit.

Çdo përfundim tjetër do ta legjitimonte ndryshimin e ofertave pas hapjes dhe do ta cenonte rëndë barazinë, transparencën dhe integritetin e sistemit të prokurimit publik.

X. CERTIFIKATAT – DETYRIMI PËR VERIFIKIMIN E PËRPUTHSHMËRISË ME KËRKESAT KONKRETE

AK ka refuzuar pretendimin lidhur me certifikatën për siguri dhe shëndet në punë duke deklaruar se certifikata përmban tema që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe se Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi nga institucioni lëshues se certifikata është e pavlefshme.

Ky arsyetim e zhvendos në mënyrë të gabuar barrën e verifikimit.

Çështja nuk është vetëm nëse certifikata është “e vlefshme” apo “e pavlefshme”.

Çështja është:

A është dokumenti konkret i paraqitur nga SCORPION GROUP SH.P.K. dëshmia e kërkuar saktësisht në Dosjen e Tenderit?

Autoriteti Kontraktues është ai që ka përcaktuar kërkesën.

Prandaj, duhet të krahasojë:

1. kërkesën konkrete në Dosjen e Tenderit;
2. dokumentin konkret të paraqitur nga SCORPION GROUP SH.P.K.;
3. përmbajtjen dhe objektin e certifikatës;
4. institucionin lëshues;
5. fushën e certifikimit;
6. periudhën e vlefshmërisë;

7. dhe përputhshmërinë e saj me kërkesën e përcaktuar.

Nuk është e mjaftueshme që një dokument të përmbajë disa terma që lidhen në mënyrë të përgjithshme me sigurinë dhe shëndetin në punë.

XI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË RISKUT

I njëjti standard vlen edhe për Raportin e Vlerësimit të Riskut.

AK ka deklaruar se Ankuesi nuk ka paraqitur prova konkrete se raporti nuk është lëshuar nga subjekt i licencuar.

Megjithatë, AK nuk duhet të presë që një operator konkurrues të provojë pavlefshmërinë e dokumentit të ofertuesit tjetër.

Detyrimi primar për të verifikuar nëse dokumenti i paraqitur përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit i takon Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, OSHP duhet të kërkojë nga AK që të paraqesë:

- Raportin e plotë të Vlerësimit të Riskut;
- të dhënat e subjektit që e ka lëshuar;
- dëshminë e licencimit, nëse kjo kërkohej;
- datën e lëshimit;
- objektin e vlerësimit;
- dhe bazën mbi të cilën Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se ky dokument përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit.

XII. MENAXHERËT DHE KONTRATAT E PUNËS

Pretendimet lidhur me menaxherët dhe dokumentacionin e tyre gjithashtu nuk mund të refuzohen vetëm me deklarin se Ankuesi nuk ka paraqitur prova se personat nuk posedojnë licencat.

Nëse Dosja e Tenderit ka kërkuar:

- menaxherë të caktuar;
- licenca;
- certifikata;
- kontrata pune;
- ose dokumente të tjera;

atëherë AK duhet të demonstrojë se ofertuesi i rekomanduar i ka përmbushur konkretisht këto kërkesa.

Në veçanti, duhet të verifikohet:

- nëse personat e propozuar janë pikërisht personat e kërkuar;
- nëse posedojnë licencat e kërkuara;

- nëse licencat janë valide;
- nëse kontratat e punës ekzistojnë dhe janë të vlefshme;
- nëse marrëdhënia juridike e tyre me operatorin ekonomik është e tillë që siguron realizimin e kërkesës së Dosjes së Tenderit;
- dhe nëse këto dokumente janë përdorur si bazë reale e vlerësimit.

Gjithashtu, gjatë kontrollimit të Dosjes së Tenderit të operatorit ekonomik të shpallur fitues, nuk janë gjetur licencat për të cilat operatori ekonomik ka qenë i obliguar t'i bashkëngjisë në kontratë. Në mungesë të këtyre licencave, Autoriteti Kontraktues është dashur të konsiderojë se oferta administrative e operatorit ekonomik nuk është e përgjegjshme dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke e eliminuar operatorin ekonomik si të papërgjegjshëm.

XIII. DOKUMENTACIONI KONFIDENCIAL NUK MUND TË PËRDORET SI ARSYETIM PËR MUNGESËN E VERIFIKIMIT

Autoriteti Kontraktues, në Vendimin e datës 10.08.2026, ka deklaruar se:

analiza financiare e SCORPION GROUP SH.P.K.;

Raporti i Vlerësimit të Riskut; dhe kontratat e punës së menaxherëve, Raporti vlerësimit të tenderave

janë trajtuar si dokumente konfidenciale dhe, për këtë arsye, nuk i janë vënë në dispozicion Operatorit Ekonomik Ankues. MEB L.L.C. nuk e konteston në mënyrë abstrakte të drejtën për mbrojtjen e informatave që, sipas nenit 11 të LPP-së, i plotësojnë kushtet ligjore për t'u trajtuar si sekrete afariste, teknike ose komerciale. Megjithatë, konfidencialiteti është përjashtim nga parimi i transparencës dhe, si i tillë, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë, të arsyetohet individualisht dhe të zbatohet vetëm ndaj pjesëve konkrete që i plotësojnë kushtet ligjore. Ai nuk mund të shtrihet automatikisht mbi dokumente të tëra vetëm për shkak se operatori ekonomik i ka emërtuar ato "konfidenciale".

Vetë deklarimi i operatorit ekonomik nuk është i mjaftueshëm. Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar ta vlerësojë në mënyrë të pavarur nëse secila informatë:

ka karakter realisht konfidencial;

nuk është e njohur publikisht;

krijon përparësi ekonomike për shkak të fshehtësisë së saj;

do t'i shkaktonte dëm konkret operatorit në rast të publikimit; dhe

mund të mbrohet ligjërisht sipas nenit 11 të LPP-së.

Vendimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë analizë të tillë. Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar:

cilat pjesë konkrete të dokumenteve janë konfidenciale;

cilin interes të ligjshëm e mbrojnë;

çfarë dëmi konkret do të shkaktonte publikimi;

përse nuk ka qenë i mundur redaktimi i vetëm të dhënave të mbrojtura; dhe

përse dokumentet janë përjashtuar në tërësi nga qasja.

KONFIDENCIALITETI NUK E PËRJASHTON DETYRIMIN PËR VERIFIKIM

Edhe kur një dokument ose pjesë e tij e plotëson ligjërisht standardin e konfidencialitetit, kjo nuk e përjashton Autoritetin Kontraktues nga detyrimi që:

ta shqyrtojë dokumentin në tërësi;

ta verifikojë autenticitetin dhe vlefshmërinë e tij;

ta krahasojë me kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit;

ta vlerësojë sipas standardit të njëjtë të aplikuar ndaj operatorëve të tjerë;

ta dokumentojë procesin e verifikimit; dhe

ta arsyetojë konkretisht përfundimin lidhur me përgjegjshmërinë e ofertës.

Dokumenti nuk bëhet automatikisht i rregullt vetëm pse është shpallur konfidencial. Konfidencialiteti rregullon vetëm mënyrën e qasjes në një informatë të mbrojtur; ai nuk provon vlefshmërinë, saktësinë ose përputhshmërinë e dokumentit me kërkesat e tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk mund ta përdorë etiketën “konfidencial” si zëvendësim për verifikimin dhe as si mburojë ndaj kontrollit administrativ dhe juridik.

ANALIZA FINANCIARE NUK MUND TË FSHEHET NË TËRËSI PA ARSYETIM INDIVIDUAL

Analiza financiare përbën dokumentin kryesor për verifikimin e mënyrës së formimit të çmimit të ofertës. Në këtë aktivitet, parametrat kryesorë të saj nuk janë sekrete të krijuara nga operatori ekonomik, por kërkesa të përcaktuara paraprakisht nga vetë Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë:

pagën bazë prej 525.00 € bruto; kontributin prej 5% të punëdhënësit; shtesat për punën gjatë natës; shtesat për vikende; kompensimin për festat zyrtare; orët shtesë; zëvendësimin gjatë pushimeve vjetore; uniformat 2 pale verore dhe dimerore; pagën e menaxherit, fitimin, TVSH-në dhe totalin e ofertës.

Këto kategori janë të njohura për të gjithë tenderuesit dhe burojnë nga dokumentacioni publik i prokurimit dhe nga

obligimet ligjore. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues nuk mund të prezumojë se e gjithë analiza financiare përbën sekret afarist.

Edhe nëse ndonjë e dhënë e kufizuar, si ndonjë element i veçantë i kostos së brendshme apo marzhës komerciale, do të mund të mbrohej, kjo nuk e arsyeton mbajtjen e fshehtë të dokumentit në tërësi.

Autoriteti Kontraktues është dashur:

t'i identifikojë vetëm pjesët që plotësojnë kriteret e nenit 11.3 të LPP-së;

t'i redaktojë vetëm ato të dhëna konkrete;

ta bëjë të qasshme pjesën tjetër të dokumentit sipas nenit 11.4;

të ofrojë përmbledhje jokonfidenciale sipas nenit 11.5; dhe

ta mundësojë verifikimin e përputhshmërisë së analizës me kërkesat e tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në këtë mënyrë. Ai nuk ka ofruar as version të redaktuar dhe as përmbledhje jokonfidenciale. Në vend të kësaj, ka zbatuar ndalim të plotë dhe të paarsyetuar të qasjes.

Ky veprim është joproporcional dhe në kundërshtim me nenet 10 dhe 11, paragrafët 3–5 të LPP-së.

KONTRADIKTA THEMELORE NË VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Autoriteti Kontraktues ka krijuar një situatë juridikisht të papranueshme:

së pari, ia ka ndaluar MEB L.L.C. qasjen në analizën financiare dhe dokumentet e tjera vendimtare;

më pas, e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim me arsyetimin se Ankuesi nuk ka paraqitur prova konkrete për mangësitë e këtyre dokumenteve. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta fshehë provën dhe, njëkohësisht, ta përdorë mungesën e saj kundër palës që ka kërkuar qasje.

Ky arsyetim përbën bartje të palejuar të barrës së provës dhe e bën mjetin juridik të Ankuesit thjesht formal. Ankuesit i është kërkuar të argumentojë përmbajtjen e një dokumenti të cilin Autoriteti Kontraktues ka refuzuar t'ia bëjë të qasshëm.

Kjo cenon:

parimin e transparencës; trajtimin e barabartë; barazinë procedurale të palëve; të drejtën për kontroll efektiv të vendimit; të drejtën për mjet juridik efektiv; dhe integritetin e procedurës së prokurimit.

DETYRIMI I OSHP-së PËR ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT

Nëse Autoriteti Kontraktues pretendon se dokumentet janë konfidenciale, OSHP-ja duhet t'i administrojë ato në

tërësi dhe të kryejë kontroll të pavarur lidhur me:

- A) bazueshmërinë e klasifikimit si konfidencial;
- B) ëmbushjen e kushteve të nenit 11.3 të LPP-së;
- C) mundësinë e redaktimit sipas nenit 11.4
- D) ekzistencën e përmbledhjes jokonfidenciale sipas nenit 11.5;
- E) vlefshmërinë dhe autenticitetin e dokumenteve;
- F) përputhshmërinë e tyre me Dosjen e Tenderit; dhe
- G) ndikimin e çdo mangësie në përgjegjshmërinë e ofertës.

OSHP-ja nuk duhet të mjaftohet me deklarin e Autoritetit Kontraktues se dokumentet janë shqyrtuar. Ajo duhet ta verifikojë vetë përmbajtjen e tyre, sepse pikërisht ligjshmëria e këtij vlerësimi është objekt i ankesës.

Konfidencialiteti ka për qëllim mbrojtjen e informatave të caktuara që përmbushin kriteret ligjore. Ai nuk ka për qëllim:

përfshirjen e dokumentacionit nga kontrolli ligjor; fshehjen e mënyrës së formimit të çmimit; pamundësimin e verifikimit të përgjegjshmërisë së ofertës; mbrojtjen e mangësive të dokumentacionit; ose kufizimin e të drejtës për mjet juridik efektiv.

Në rastin konkret, klasifikimi i plotë i analizës financiare, Raportit të Vlerësimit të Riskut dhe kontratave të menaxherëve, pa arsyetim individual, pa redaktim dhe pa përmbledhje jokonfidenciale, përbën shkelje të neneve 7, 10, 11, 24, 59 dhe 108/A të LPP-së.

Për këto arsye, kërkohet nga OSHP-ja që:

ta konstatojë si të kundërligjshëm kufizimin e plotë të qasjes;

ta detyrojë Autoritetin Kontraktues të arsyetojë individualisht çdo të dhënë të mbrojtur;

të urdhërojë ofrimin e versioneve të redaktuara dhe përmbledhjeve jokonfidenciale;

të administrojë dhe verifikojë drejtpërdrejt dokumentet në fjalë;

të vlerësojë nëse ato i plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit; dhe

nëse konstatohet mungesë ose mospërputhje materiale, ta shpallë ofertën e SCORPION GROUP SH.P.K. të papërgjegjshme.

XV. MOSPËRPUTHJA MIDIS VENDIMIT TË AK-së DHE PRAKTIKËS SË TIJ TË VITIT 2024

Një nga çështjet më të rëndësishme që kërkon vëmendje dhe shqyrtim të posaçëm nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së është mospërputhja e drejtpërdrejtë ndërmjet standardit të vlerësimit të zbatuar nga Autoriteti Kontraktues në vitin 2024 dhe standardit të përdorur në procedurën aktuale.

Kjo çështje nuk paraqet thjesht referim në një procedurë të mëparshme të parëndësishme për kontestin aktual.

Bëhet fjalë për:

- të njëjtin Autoritet Kontraktues;
- të njëjtin objekt të prokurimit;
- të njëjtin lloj shërbimi;
- të njëjtën natyrë të kostove financiare;
- pjesëmarrjen e MEB L.L.C.;
- pjesëmarrjen e SCORPION GROUP SH.P.K.; dhe
- kërkesa financiare që në të dyja procedurat kanë pasur për qëllim verifikimin e realizueshmërisë së çmimit të ofertuar.

Në aktivitetin e vitit 2024, Autoriteti Kontraktues kishte zbatuar standard rigoroz gjatë ekzaminimit të analizave financiare. Në atë procedurë, Autoriteti Kontraktues kishte analizuar në mënyrë të detajuar:

- pagat bazë të punëtorëve;
- kontributet e punëdhënësit;
- strukturën dhe numrin e orëve të punës;
- orët e punës gjatë natës;
- punën gjatë vikendeve;
- punën gjatë festave zyrtare;
- orët shtesë;
- pushimet vjetore dhe mjekësore;
- kostot e zëvendësimit të punëtorëve;
- uniformat;
- pagën dhe kontributet e menaxherit;
- fitimin;
- TVSH-në; dhe
- përputhjen matematikore të këtyre elementeve me çmimin përfundimtar.

Në bazë të këtij standardi, Autoriteti Kontraktues kishte konstatuar mospërputhje në analizën financiare të MEB L.L.C. dhe e kishte konsideruar ofertën e saj të papërgjegjshme. Ligjshmëria e asaj procedure ishte trajtuar më pas edhe pranë OSHP-së në lëndën **2024/0570**. MEB L.L.C., pavarësisht se nuk ishte pajtuar me rezultatin e asaj procedure, i ishte nënshtruar standardit strikt të vendosur nga Autoriteti Kontraktues dhe të shqyrtuar nga OSHP-ja. Pikërisht për këtë arsye, në procedurën aktuale MEB L.L.C. e ka përgatitur analizën financiare në mënyrë të hollësishme, duke përfshirë të gjitha elementet e kërkuara nga FDT-ja, Njoftimi për Kontratë dhe Aneksi 1.

Megjithatë, në procedurën aktuale, kur pretendimet lidhen me ofertën e SCORPION GROUP SH.P.K., Autoriteti Kontraktues ka adoptuar një standard thelbësisht më të ulët të verifikimit.

KRAHASIMI I STANDARDEVE TË ZBATUARA

Çështja e vlerësimit	Procedura e vitit 2024 ndaj MEB L.L.C.	Procedura aktuale ndaj SCORPION GROUP SH.P.K.
Analiza financiare	Shqyrtim i detajuar i përmbajtjes dhe kalkulimeve	Konstatim i përgjithshëm se analiza “është shqyrtuar”
Pagat dhe kontributet	Verifikim konkret i vlerave	Pa paraqitje të vlerave dhe formulave konkrete
Orët e natës, vikendeve dhe festave	Shqyrtim i ndarë dhe i hollësishëm	Pa ndarje të publikuar dhe pa kalkulim të verifikueshëm
Pushimet dhe zëvendësimet	Trajtuar si elemente materiale	Vetëm deklaram se janë përfshirë
Paga e menaxherit	Verifikuar konkretisht	Pa vlerë konkrete dhe pa formulë
Fitimi	Analizuar si pjesë e strukturës së çmimit	Pretendim i pabazuar se MEB ka synuar fitim më të lartë
Pasoja e mospërputhjes	Oferta e MEB L.L.C. është konsideruar e papërgjegjshme	Oferta e SCORPION GROUP SH.P.K. është pranuar pa verifikim të qasshëm
Qasja në analizën financiare	Analiza është administruar dhe shqyrtuar në procedurën pranë OSHP-së	MEB L.L.C. është privuar nga qasja në analizën e fituesit
Barra e provës	MEB L.L.C. është dashur ta dëshmojë plotësisht përputhshmërinë	MEB L.L.C. është kërkuar të provojë mangësitë e dokumentit të fshehur
Ky krahasim dëshmon se nuk kemi të bëjmë me një dallim të vogël në formulim, por me ndryshim thelbësor të standardit të ekzaminimit dhe vlerësimit. Në vitin 2024, për MEB L.L.C., Autoriteti Kontraktues ka kërkuar verifikim zë për zë dhe ka nxjerrë pasoja eliminuese nga mospërputhjet e konstatuara. Në vitin 2026, për SCORPION GROUP SH.P.K., i njëjti Autoritet Kontraktues është mjaftuar me deklarime të përgjithshme, pa bërë të qasshme analizën financiare dhe pa paraqitur asnjë kalkulim që dëshmon përmbushjen e kërkesave.		

Vendimi i datës 10.08.2026 nuk përmban asnjë arsyetim që do ta shpjegonte:

1. përse standardi i vitit 2024 nuk është zbatuar edhe në procedurën aktuale;
2. përse mospërputhjet financiare që më parë konsideroheshin materiale tani trajtohen në mënyrë tolerante;
3. përse për MEB L.L.C. është kërkuar verifikim i hollësishëm, ndërsa për SCORPION GROUP SH.P.K. është pranuar konstatim i përgjithshëm;
4. përse analiza financiare e operatorit të rekomanduar është përjashtuar nga qasja;
5. përse nuk është shpjeguar çmimi identik prej 4.93 € për orë për shërbimin 24/7 dhe atë tetëorësh;
dhe
6. përse nuk është verifikuar burimi i diferencës prej 9,815.04 € ndërmjet ofertës së MEB L.L.C. dhe ofertës së rekomanduar.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se dokumentacioni ose sqarimet e procedurës aktuale e arsyetojnë përdorimin e një metodologjie tjetër, ai ka qenë i obliguar të shpjegojë se si ajo metodologji i përfshin të gjitha kostot e detyrueshme dhe prodhon rezultat të verifikueshëm.

Lejimi i një formati tjetër të analizës nuk e arsyeton mungesën e ndonjë kostoje dhe as mosverifikimin e saj. Ndryshimi i formës nuk e ndryshon përmbajtjen obligative të kërkesave.

Neni 7 i LPP-së e obligon Autoritetin Kontraktues që kërkesat e dokumentacionit të tenderit t'i zbatojë sipas standardit të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk mundet:

- ta eliminojë MEB L.L.C. në vitin 2024 për mospërputhje të analizës financiare;
- në procedurën aktuale ta konsiderojë SCORPION GROUP SH.P.K. të përgjegjshme pa paraqitur të njëjtin nivel verifikimi;
- ndaj një operatori t'i interpretojë kërkesat në mënyrë strikte;
- ndaj operatorit tjetër t'i interpretojë në mënyrë tolerante; dhe
- më pas ta arsyetojë këtë dallim me deklarime të përgjithshme dhe të pakontrollueshme.

Nëse një mangësi financiare ka qenë materiale dhe eliminuese në vitin 2024, ajo nuk mund të bëhet jomateriale në vitin 2026 vetëm për shkak se operatorit ndaj të cilit zbatohet standardi është tjetër.

Ky dallim në trajtim cenon:

- barazinë ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- parashikueshmërinë e procedurës;
- sigurinë juridike;
- transparencën;
- konkurrencën e ndershme; dhe

- integritetin e procesit të vlerësimit.

MEB L.L.C. thekson se ndryshimi kaq i thellë i standardit, në mungesë të çdo arsytimi objektiv, nuk mund të reduktohet pa shqyrtim në një “gabim të thjeshtë interpretimi”.

Rrethanat krijojnë dyshim objektiv dhe të arsyeshëm se kriteret e Dosjes së Tenderit janë zbatuar në mënyrë selektive, varësisht nga operatori ndaj të cilit kanë prodhuar pasoja.

Në veçanti, ky dyshim mbështetet në faktin se:

- ndaj MEB L.L.C. është zbatuar standard strikt dhe eliminues;
- ndaj SCORPION GROUP SH.P.K. është zbatuar standard më tolerant;
- dokumentacioni vendimtar i operatorit të rekomanduar është mbajtur i fshehtë;
- pretendimet janë refuzuar për mungesë të provave në të cilat AK ka ndaluar qasjen;
- nuk janë paraqitur kalkulime konkrete; dhe
- nuk është dhënë asnjë arsytim për devijimin nga praktika e vitit 2024.

Këto rrethana kërkojnë kontroll të plotë nga OSHP-ja. Pa administrimin dhe krahasimin e dokumentacionit të të dyja procedurave, nuk mund të konsiderohet se vendimi aktual është rezultat i një vlerësimi objektiv dhe të paanshëm.

Pretendimi për veprim të qëllimshëm duhet të vlerësohet nga Paneli mbi bazën e provave të administruara. Megjithatë, modeli i kundërt i trajtimit përbën indikator serioz të arbitraritetit dhe e ngarkon Autoritetin Kontraktues me detyrimin për ta justifikuar bindshëm ndryshimin e standardit. Vendimi i kundërshtuar nuk e jep një justifikim të tillë.

Veprimi i Autoritetit Kontraktues përbën shkelje të:

- nenit 7 të LPP-së – trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi;
- nenit 24 të LPP-së – përgjegjësia për zhvillimin e ligjshëm të aktivitetit;
- nenit 56 të LPP-së – zbatimi i kërkesave të përcaktuara paraprakisht;
- nenit 59.2 dhe 59.4 të LPP-së – ekzaminimi dhe përgjegjshmëria e tenderëve;
- nenit 60 të LPP-së – zbatimi i kriterit të dhënies vetëm ndërmjet tenderëve të përgjegjshëm;
- nenit 61 të LPP-së – verifikimi i realizueshmërisë së çmimit;
- nenit 108/A të LPP-së – shqyrtimi efektiv dhe i arsytuar i kërkesës; dhe
- dispozitave përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

XVII. AK NUK MUND TË NDRYSHOJË STANDARDIN E VLERËSIMIT PAS HAPJES SË OFERTAVE

Një nga parimet themelore të prokurimit publik është që operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të përgatisin ofertat e tyre duke u bazuar në kërkesat e publikuara.

Nëse Dosja e Tenderit kërkon një analizë financiare të strukturuar në mënyrë të caktuar, të gjithë operatorët duhet

të vlerësohen sipas të njëjtit standard.

Nuk është e pranueshme që:

- gjatë përgatitjes së ofertave të kërkohet një standard;
- një operator të eliminohet në të kaluarën për mosrespektimin e tij;
- ndërsa më vonë, kur një operator tjetër nuk përputhet me të njëjtin standard, AK ta konsiderojë atë si çështje të parëndësishme.

Një praktikë e tillë cenon jo vetëm barazinë e operatorëve, por edhe transparencën dhe besueshmërinë e të gjithë procedurës.

XVI. DËMI I SHKAKTUAR ANKUESIT

MEB L.L.C. është palë e interesuar në këtë procedurë dhe ka paraqitur ofertë me synim të ligjshëm për fitimin e kontratës. Përzgjedhja e një oferte që nuk i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit, nëse e privon Ankuesin nga mundësia reale për tu shpallur fitues i kontratës, për tu shpërblyer me kontratë dhe për të realizuar fitimi nga kontrata. Në të njëjtën kohë, një procedurë e tillë cenon interesin publik, pasi kontrata publike duhet t'i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme më të favorshme në pajtim me kriteret e shpallura dhe jo operatorit që përfiton nga interpretimi i ndryshëm i të njëjtave kërkesa.

Duke marrë parasysh shkeljet e evidentuara, veçanërisht aplikimin e standardeve të ndryshme të vlerësimit, mungesën e verifikimit të plotë të ofertës së rekomanduar dhe mospërputhjen ndërmjet praktikës së mëparshme dhe qëndrimit aktual të Autoritetit Kontraktues, MEB L.L.C. konsideron se Vendimi i datës 10.08.2026 nuk mund të mbetet në fuqi.

Për këto arsye, kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë ankesë dhe të urdhërojë masat përkatëse për rivendosjen e ligjshmërisë në këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj, bazuar në të gjitha faktet dhe provat e paraqitura në këtë ankesë, si dhe në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, dispozitat relevante të legjislacionit të punës në fuqi, kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, si dhe sqarimet dhe përgjigjet zyrtare të dhëna nga Autoriteti Kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, MEB L.L.C. kërkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit që të nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Ta pranojë** këtë ankesë si të bazuar dhe të ligjshme;

2. **Të anulojë** Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Spitali “Sheikh Zayed” – Vushtrri, të datës 10.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e MEB L.L.C. dhe është lënë në fuqi rezultati i procedurës së

prokurimit;;

3. **Të konstatojë** se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-së, veçanërisht nenin 7 dhe nenin 59, si dhe dispozitat përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022, për shkak të aplikimit jo të njëjtë të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe mungesës së një vlerësimi objektiv e të plotë të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar;

4. **Të obligojë** Autoritetin Kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave, me një komision të vlerësimit në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, duke zbatuar të njëjtat kritere dhe të njëjtin standard ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë pas rivlerësimit të ligjshëm dhe eliminimit të ofertave që nuk i përmbushin kërkesat e dokumentacionit të tenderit, konstatohet se MEB L.L.C. është tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm, Autoriteti Kontraktues të nxjerrë vendim të ri dhe ta rekomandojë **MEB L.L.C. për dhënien e kontratës**, në përputhje me nenin 60 të LPP-së dhe kriterin e përcaktuar në pikën 30.1 të FDT-së.

5. Në kuadër të rivlerësimit, të obligohet AK që në mënyrë të veçantë ti permbahet kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit dhe dispozitave ligjore të Ligjitt e Prokurimit Publik dhe Rregullores Nr. 001/2022 pas rivlerësimit të ligjshëm dhe eliminimit të ofertave që nuk i përmbushin kërkesat e dokumentacionit të tenderit, konstatohet se MEB L.L.C. është tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm, Autoriteti Kontraktues të nxjerrë vendim të ri dhe ta rekomandojë **MEB L.L.C. për dhënien e kontratës**, në përputhje me nenin 60 të LPP-së dhe kriterin e përcaktuar në pikën 30.1 të FDT-së.

Me respekt,